

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7873 E diel 5 Maj 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

**K**a një numër banditësh mes atyre shumë njerëzve të ndershëm, që prodhojnë ushqimin e përditshëm për popullatën. Është një kategori vrasësish serialë ...  
Vijon në faqen 22

Nga LORENC VANGJELI

**Armiku në tryezë**



Opinion **Ditës**

Nga ANDI BUSHATI

**Dështimi i propagandistëve të idesë së Vuçiçit**



Falsifikohet vendimi për kthimin e pronës  
**Skandali i tjetërsimit të tokës tek Ushtaraku, në pranga 2 pronarët e ndërtuesi, ja skema**

Dyshimi, të implikuar edhe zyrtarë të Hipotekës. Abuzimi u zbulua pas kallëzimit të trashëgimtarit  
Një ndërtues me probleme të hershme me drejtësinë dhe dy pasardhës të familjes së njohur tiranase, Pazarit, u ndaluan me urdhër të Prokurorisë së Tiranës, pas dyshimeve për pastrim parash, lidhur me skandalin e tjetërsimit të pronave të Spitalit Ushtarak. Hetimet kanë zbuluar se Kadri Pazarit dhe Arben Çaçi kanë mundur të falsifikojnë vendimin nr:232 ...  
Në faqen 9

## EMRAT/ TOKAT E ZENA NGA "INFORMALET", SI NDAHEN 105 MLN KOMPENSIMI I PRONAVE, 300 FAMILJET QE MARRIN PARATE

Agjencia e Kadastrës: Përfituesit në Tiranë dhe në rrethe. Dokumentet që nevojiten, karta e identitetit dhe llogaria bankare aktive



(Në foto) Zonë informale

**EURODEPUTETJA**  
**Krisa politike, Doris Pack: Bandat e kanë dëmtuar imazhin e Shqipërisë**  
Në faqen 4

**KOMISIONI**  
**Kuvendi, letër PD-së: Caktoni vëzhguesin për reformën zgjedhore**  
Në faqen 3

**KURBIN**  
**I akuzuari për vrasjen e dy kushërinjve në gjiq: U pendova**  
Në faqen 8

**ARRESTIMET**  
**Operacioni i RENE, pranga dy të kërkuarve nga Shkodra**  
Në faqen 10

**JA PLATFORMA EKONOMIKE**  
**Konventa e LSI, Kryemadhi: Nuk ndalet protesta, e ardhmja pa Ramën**  
Në faqen 2

**MIOLO** Analiza e Gjergj Frashërit: Çfarë përmban vepra voluminoze e historianit  
**Jeta dhe vepra e Skënderbeut, sipas Kristo Frashërit**  
*Në brendësi: A po merr udhë prishja e Teatrit, nga Ben Andoni*

Nga GJERGJ FRASHËRI  
Është domethënëse dedikimi që historiani akademik Kristo Frashëri i ka bërë veprës së tij në fjalët e mëposhtme: "Nuk është i saktë pohimi i disa historianëve skeptikë, se Skënderbeun e ngriti në pedestalin e his-



torisë shekullore - jo vepra e tij, e cila, sipas tyre, ka qenë modeste, por Marin Barleti me stilin e vet elegant, klasik dhe humanist. Në këtë punim provohet e kundërta. Është Skënderbeu ai, që me madhësinë e veprës së tij frymëzoi bashkatdhetarin e vet, Barletin ...  
Suplement

## NGËRÇI POLITIK OPOZITA

LSI miraton rezolutën: Nga rritja e pagave, te TVSH-ja dhe mbështetja për bujqësinë

# Kryemadhi: Mosbindja civile s'ndalet, e ardhmja pa Edi Ramën

"Bishë e plagosur, që do të rrëzohet shumë shpejt"

Valentina Madani

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, prekontoi dje në Konventën Kombëtare të partisë që ajo drejton platformën ekonomike, që do të shpaloset para shqiptarëve. Rritje pagash për mësuesit 50% në 4 vite, TVSH 0% për prodhimin bujqësor, TVSH 6% për produktet e shportës, heqja e pagesës së TVSH-së në doganë, pagesë fikse tatimi prej 30 mijë lekësh në vit për gjithë bizneset me xhiro vjetore nga 2 deri 8 milionë lekë në vit. Këto janë vetëm disa nga premtimet në rezolutën e LSI-së. "Lëvizja Socialiste për Integritim, me përgjegjësi kombëtare e politike, shpall si objektiv madhor kthimin e besimit të qytetarëve të shtetit, të Shqipërisë, si shtetëpia jonë e përbashkët", deklaroi zy.Kryemadhi.

### MESAZHET

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, dha disa mesazhe nga konventa e partisë. Ajo e cilësoi kryeministrin Edi Rama një telekomandë me dy funksione, që komandon krimin dhe komandohet nga ata, por që nga sot e tutje LSI-ja nuk do të tërhiqet nga angazhimi i saj për largimin e shefit të qeverisë. Në fjalimin përpara anëtarëve të Lëvizjes Socialiste për Integritim, Monika Kryemadhi u bëri thirrje shqiptarëve të bashkohen në protestën e 11 majit duke nënvizuar se nuk do të ketë zgjedhje farsë pa opozitën. "Trëndafilin e Partisë Socialiste e ka zëvendësuar me oturakun e qarqeve antishqiptare", deklaroi kryetarja e LSI-së duke akuzuar kryeministrin Edi Rama si një faktor pro ndarjes së Kosovës. Në Konventën Kombëtare kryetarja e LSI-së garantoj se protestat dhe mosbindja civile nuk do të ndalen derisa të ketë zgjedhje të lira dhe jo farsë, do apo nuk do "sulltani i krimi". "Në këtë vend fatmirësisht ata që nuk pranuan të bëhen fas-



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi dje gjatë Konventës Kombëtare

## Vasili nxjerr mesazhin: Kryetarja e Komitetit të Helsinkit në Serbi: Rama, partner i Beogradit

Ish-deputeti i LSI-së, Petrit Vasili, ndau dje me ndjekësit e tij në rrjetet sociale, deklaratën e bërë nga kryetarja e Komitetit të Helsinkit në Serbi, Sonja Biserko. Sipas Vasilit, Biserko e ka thënë qartë se kryeministri Rama është partner i Beogradit në Tiranë dhe ka zbuluar se bisedimet për ndarjen e kufijve kanë nisur që në vizitën e tij në Nish, dy vite më parë. Kohë, kur për fat, sipas tij, ndërhyri Uashingtoni dhe Londra. "Kryetarja e Komitetit të Helsinkit në Serbi Sonja Biserko me qartësi vrasare na i zbulon autorët e projektit të ligë e antishqiptar, që nga kryeprogonistit, bashkautorit dhe bashkideatori Edi Rama si një shtetë profesionalist i interesave kombëtare e pastaj të tjerët... Lexojeni ç'është Sonja Biserko: "Në të vërtetë, Beogradi gjatë kohës ka kërkuar partner në Tiranë dhe më në fund e ka gjetur atë: është kryeministri shqiptar Edi Rama. Ato bisedime (për ndarjen) filluan para dy vitesh kur Rama ishte në Nish, por atëbotë e zbuluan Uashingtoni dhe Londra

Të gjithë këta emra tërhiqen vëmendjen të projekti i ndarjes. Kjo tani nuk është më marrëveshje mes Thaçit dhe Vuçiqit, përkatësisht Vuçiqit dhe Ramës, por ka edhe konotacion të ri ndërkombëtar. Deri së fundi për këtë nuk ka pasur përkrahje nga bota e jashtme", - shprehet z.Vasili.

adë e Edi Ramës janë sot shumica dhe sot shumica është opozita e bashkuar dhe jo vetëm, por me të gjithë ata shqiptarë, të cilët duhet të bashkohen dhe të rrëzojnë këtë regjim kriminal, protestat tona dhe mosbindja civile do të vazhdojnë derisa 'sulltani i krimi' të bindet me hir a me pahir, do apo nuk do ai, në Shqipëri do të ketë zgjedhje të lira dhe të ndershme. Koha e tij dhe e etërve të tij ka mbaruar në Shqipëri", u shpreh krye-

etarja e LSI-së.

### NDRYSHIMET

Drejtuesja e LSI, Monika Kryemadhi, gjatë fjalës së saj nuk i kurseu sulmet dhe akuzat në drejtim të kryeministrin Rama, ndërsa u shpreh e bindur se zgjedhje pa opozitën nuk ka për të pasur. Ajo u ndal edhe te propozimet për ndryshimet në Kodin Penal, ku e cilësoi kryeministrin si një bishë të plagosur; që po kërcënon shqiptarët pasi po rrezikon pushtetin. "Zgjedhje

### RRËZIMI

"Zgjedhje nuk ka për të pasur as në ëndërr, as në makthin e tij. Bisha e plagosur në thagmat e fundit të saj bëhet më e tërbuar. Kërcënojnë shqiptarët me Kod Penal, që do të thotë që frika i ka përpirë dhe helmi që kanë futur në trupin e insektit të tyre do t'i tresë. Prandaj të gjithë së bashku duhet të punojmë për ta rrëzuar këtë regjim, për ta kthyer Shqipërinë në shtetëpinë e shqiptarëve", - tha zy.Kryemadhi.

ëndërr, as në makthin e tij. Bisha e plagosur në thagmat e fundit të saj bëhet më e tërbuar. Kërcënojnë shqiptarët me Kod Penal, që do të thotë që frika i ka përpirë dhe helmi që kanë futur në trupin e insektit të tyre do t'i tresë. Prandaj të gjithë së bashku duhet të punojmë për ta rrëzuar këtë regjim, për ta kthyer Shqipërinë në shtetëpinë e shqiptarëve", theksoi zy.Kryemadhi. Më tej ajo iu përgjigj edhe batutave të kryeministrin, ku theksoi se i doktorëshë e fallxhore e parashikoj të ardhmen e vendit të ndritur e pa Ramën. "LSI është si doktori që do të shërojë të sëmurin e përherëshëm, për të shëruar sëmundjen kronike që Shqipëria ka 30 vjet në tranzicion që e kalon. Edhe si doktorëshë, edhe si fallxhore e parashikoj të ardhmen e Shqipërisë të ndritur; të begatë, pa Edi Ramën kryeministër", u shpreh kryetarja e LSI-së. Monika Kryemadhi kërkoi angazhimin e LSI-së për të bindur qytetarët t'i bashkohen protestës së 11 majit për t'i dhënë dërrmën përfundimtare siç tha ajo "këtë regjim kriminal".

### AKUZAT

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, shfrytëzoi dje Konventën Kombëtare për të bërë të qartë se aksioni i opozitës për rrëzimin e qeverisë nuk do të ndalet. E për të ilustruar këtë, Kryemadhi recitoi një prej zënjëve të Dritëro



Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, dje në Lezhë

## PLATFORMA EKONOMIKE, PROPOZIMET E LSI-SË PËR UJLJE TAKSASH

- (i) Ujle e barrës fiskale mbi biznesin dhe individin: Thjeshtëzim i sistemit fiskal dhe i barrës fiskale përmes një takse të sheshtë prej 10% për tatim fitimes dhe të ardhurat personale.
  - TVSH 0% për prodhimin bujqësor.
  - TVSH 6% për produktet e shportës.
  - Heqja e pagesës së TVSH-së në doganë.
  - Pagesë fikse tatimi prej 30 mijë lekësh në vit për gjithë bizneset me xhiro vjetore nga 2 deri 8 milionë lekë në vit.
  - Heqja e tatimit të transferimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme.
  - Pagesa vetëm 1% takse mbi shumën e transaksionit. Për blerjen e shtetëpisë së parë pagesa është 0.
  - Ujle e tavanit të taksave vendore për t'i dhënë fund abuzimit me to.
  - Mbështetje me grant 20000 euro për 'start-up'-et.
- Sektor kryesor ekonomik, bujqësia.
  - Subvencionim i prodhimit bujqësor për njësi të prodhimit, të sipërfaqes dhe për numër krerësh. (100 milionë euro në vit).
  - Subvencionim i vlerës së interesit bankar për çdo kredi të dhënë për infrastrukturë, serra, stalla, për industrinë agropëruanuese. Ofrim i tokës shtetërore për aktivitetet agropëruanuese.
  - Ndërtimi i sistemit të Kartës së Fermitit me zbatimin e së cilës bëhet zbatimi automatik e pagesës së TVSH-së për imputet bujqësore, plehra kimike, fidanë, fara, naftë.
  - Konsolidim i rajonalizimit të prodhimit bujqësor.
  - Dhënie e certifikatave të pronësisë mbi tokën brenda dy viteve të para të qeverisjes.
  - Targetim i zëvendësimit me përparësi të importeve të produkteve të përpunura me prodhime vendi.
  - Forcimi i sigurisë ushqimore. Inpute të sigurt dhe proces prodhimi i sigurt. Ndërtimi i një laboratorit të kontrollit ushqimor për çdo qark.
- Mbështetje përësore për arsimin.
  - Dyfishim buxheti për përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe paga mësuesit. Rritje pagash për mësuesit 50% në 4 vite.
  - Rritje e cilësisë së mësimdhënies.
  - Rritje e autonomisë universitare që u garanton studentëve dhe pedagogëve rritje të cilësisë së mësimdhënies dhe lidhje me tregun e punës.
  - Orientim i 50% të temave studimore në programet master dhe PHD në çështje konkrete të zhvillimit të ekonomisë.
  - Realizimi i Programit "Meso dhe fito" për shkollat profesionale (punësim me pagë dhe mësim) dhe për shkencat e aplikuar.
- Mbështetje e familjes së re.
  - Krijimi i fondit të shtëpieve për familjet e reja.
  - Punësim përësor për të paktën një nga prindërit e një familje me fëmijë.

Agollit. "Unë u rraha me ta e u grisa në gjoks e krahë, si mund të rrija në paqe? Poeti duhet të dijë të rrahë dhe jo vetëm të thurë vargje". E pra, me do të dhënë si të sillemi me këta vagabondë", tha ajo. Kryemadhi sulmoi kryeministrin Rama jo vetëm për mënyrën si ka qeverisur Shqipërinë, por edhe për qëndrimin ndaj Kosovës. "Pikërisht se trëndafilin e Partisë Socialiste e ka zëvendësuar me oturakun e qarqeve antishqiptare. Pikërisht sepse edhe në politikë, edhe në diplomaci flasin me

gjuhën e PPP-ve, guxuan deri sa të hedhin në treg për turpin e tyre dhe ndarjen e Kosovës. Aq sa u desh një samit i madh evropian për t'u dhënë një 'jo' të madhe pazaxhajnive të trojeve shqiptare", deklaroi zy.Kryemadhi. Ajo shfrytëzoi epitetet që përdor kryeministri Rama për të theksuar sekauza e opozitës do të fitojë. "Edhe si doktorëshë, edhe si fallxhore e parashikoj të ardhmen e Shqipërisë të ndritur, të begatë, pa Edi Ramën kryeministër", u shpreh kryetarja e LSI-së.

REDAKSIJA: Redaktor i Supplementeve dhe Socials: Rezarta Delisula, Dossier: Iv Kaloci, Redaktor i Rretheve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli,

Art Designer: Nevila SAMARXHI, ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtorja e Uzinës së Autokorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123, Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com, redaksia@gazetashqiptare.com, SHYTPUR në "Klasik" Shpk



**ENKELEJDA OLLDASHI**

Kryedemokrati Lulzim Basha zhvilloi djë një tryezë me pedagogë të universiteteve publike dhe përfaqësues të arsimit të lartë në vend. Por, ajo që tërhoqi vëmendjen e medias ishte prania e bashkëshortes së ish-deputetit të ndjerë Sokol Olldashi, Enkelejda Olldashi, e cila shtrëngoi duart me z.Basha. Ajo prej vitesh është pedagoqe në Universitetin e Tiranës.



**PD, Spaho: Tirana, lavatriçja më e madhe e parave të pista**

Këshilltari demokrat në Bashkinë e Tiranës, Mateo Spaho, në një konferencë për mediat akuzoi djë se kryebashkiaku Erion Veliaj e ka shndërruar Tiranën në lavatriçen më të madhe të parave të pista. "Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj, e ka shndërruar kryeqytetin në lavatriçen më të madhe të pastrimit të parave të pista në Ballkan. Veliaj përdor pushtetin për të grabitur pronat. Ai do të hyjë në histori për betonizimin që i ka bërë Tiranës. Veliaj ka vënë gjithë buxhetin e bashkisë në shërbim të tij, të propagandës dhe shpenzimeve të tjera, që s'kanë lidhje drejtpërdrejtë me përmirësimin e jetës së qytetarëve. Veliaj ka dhënë më shumë se 400 leje ndërtimi për një vit. Ai e ktheu Tiranën në një vend ku 'mbillen' kulla betoni dhe bëhet pastrim parash", deklaroi Spaho. Këshilltari i Bashkisë së Tiranës, Mateo Spaho, u shpreh se qytetarët e Tiranës nuk meritojnë një kryebashkiak si Erion Veliaj.

PD kthen taksën e sheshtë, ulje taksash, rritje pagash e pensionesh

**Protesta, Basha: Përballja vendimtare, do të luftojmë dhëmb për dhëmb**

*"Nga ardhja e PD në pushtet kanë frikë 5-6 oligarkë"*

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, nga qyteti i Lezhës ftoi shqiptarët që t'i bashkohen protestës së 11 majit në Tiranë, në një tjetër përballje kundër kryeministrit Edi Rama. Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, në një takim me mbështetës të PD-së në Lezhë deklaroi se "kryengritja popullore" e nisur më 16 shkurt nuk do të ndalet deri në largimin e kryeministrit Edi Rama, krijimin e qeverisë teknike, që do ta çojë vendin në zgjedhje të parakohshme. "11 maji na thërret në një tjetër përballje vendimtare të vlerave tona të lirisë, demokracisë, Europës. T'u presim dorën oligarkëve dhe krimin të organizuar që kanë futur dorën në xhepin e shqiptarëve", deklaroi kreu i PD-së. Edhe lezhjanëve, Lulzim Basha u premtoi se do t'i shkojë deri në fund betejës se nisur për t'u hapur rrugën zgjedhjeve të lira dhe një qeverie, që ndryshe nga ajo e Edi Ramës, mendon për ta. Ai u tha demokratëve të Lezhës se Rama ka mundur ta marrë e ta mbajë pushtetin vetëm përmes frikësimit të qytetarëve, një instrument që sipas tij nuk po funksionon më. Ai shpallosi pjesë nga programi ekonomik i PD-së, kur ajo të vijë në pushtet. Masa e parë e PD-së do të jetë ndryshimi i sistemit të taksave. "Duke sjellë në Shqipëri modelin konkurrues të taksës së sheshtë 9%. Duke konsideruar biznes të vogël çdo aktivitet ekonomik nën 140 mln lekë të vjetra në vit dhe duke i dhënë një dhe vetëm një detyrim 0.5% të xhiros vjetor", tha z.Basha. Kreu i PD-së premtoi rritje të pensioneve dhe pagave dhe fondet sipas tij do të sigurohen nga konfiskimi i pronave të personave që i kanë përfituar përmes korrupsionit. "Për pensionin minimal 250 lekë në muaj", u shpreh Lulzim Basha.

**PREMTIMI**

Kreu i PD-së garantoj se e ka vullnetin për t'ua hequr nga duart paratë publike oligarkëve dhe për të mundësuar me to vende të reja pune për të rinjtë dhe rritje ekonomike. "Sa është fatura e abuzimit të kësaj qeverie, vitin e kaluar 1.7 mld euro. Të vetmit që duhet të kenë frikë nga ardhja e PD-së dhe opozitës në pushtet janë ata 4-5 oligarkë, të cilëve



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, djë me Enkelejda Olldashin

**PD, Bardhi: Komisioni është i paligjshëm**

Reforma zgjedhore, Kuvendi letër PD-së: Caktoni vëzhguesin në komision

Kuvendi i Shqipërisë i ka kërkuar ftesë zyrtare Partisë Demokratike për të marrë pjesë në punimet e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore. Me anë të një letre të firmosur nga sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, Genc Gjonçaj, i kërkohet selisë blu që të përcaktojë përfaqësuesin e saj politik në rolin e vëzhguesit, me të drejta të plota me dy bashkëkryetarët e komisionit. Edhe pse PD e ka marrë ftesën ditën e premte, ende nuk ka një përgjigje në lidhje me daktimin e vëzhguesit. Pasi, sipas sekretarit të përgjithshëm të kësaj partie Gazmend Bardhi, shkresa e Kuvendit nuk është prioritet i PD-së. Bardhi pranon se ftesa ka mbërritur në selinë blu pasditën e të premtes dhe se po shqyrtohet, por ai shprehet se ky komision, mandati i të cilit është zgatur deri në nëntor të 2019-ës, është i paligjshëm. Dhe duke analizuar situatën, në kushtet kur opozita doli ka parlamenti duke e vendosur si kusht për zgjidhjen politike largimin e qeverisë "Rama", ftesa e shumicës ngjan me një formalitet. Edhe vetë mazhoranca, ndonëse ka marrë disa herë refuzimin e PD-së, ka sqaruar se ftesa është tregues i vullnetit të saj për ta përfshirë opozitën në realizimin e kësaj reforme, si kusht nga Brukseli për negociatat. Objekti i punës së Komisionit të Reformës Zgjedhore do të jetë edhe kërkesa e opozitës së re në parlament për të ndryshuar sistemin zgjedhor, kërkesë kjo që i është drejtuar Partisë Demokratike edhe nga aleatët e saj.



do t'ua marrim ato para për t'ua dhënë studentëve, të rinjve shqiptarë. Unë e di që kanë frikë dhe iu them bëni mirë të keni frikë, sepse kjo do të bëhet me ndihmën e Zotit, bashkimin e shqiptarëve. Në fund të kësaj beteje e pret një qeveri dhe një kryeministër që do vendosë taksën më të ulët, në funksion të një prioriteti absolut të PD-së, punësimin. Kjo është masa e parë stabilizuese,

por kemi një vizion të plotë për ta kthyer punësimin në një realitet të prekshëm", u shpreh z.Basha. Në Lezhë kryedemokrati ishte si pjesë e fushatës së nisur nga PD-ja për të rritur anëtarësimet e reja.

**TAKIMI**

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, zhvilloi pasditën e djeshme një tryezë me pedagogë e të ftuar për gjenden e

arsimit të lartë në Shqipëri. E ftuar ishte edhe Doris Pack, europarlamentare dhe aktiviste e njohur si mbështetëse e demokratëve. Tryeza është zhvilluar me përfaqësues të botës akademike në universitetet publike, për të adresuar krizën e rëndë të arsimit të lartë. Në këtë tryezë Basha tha se universitetet në vend janë në krizën më të thellë në 29 vjet, ndërsa shtoi se buxheti për arsimin e lartë nuk shkon për infrastrukturë universitetesh, por për të rregulluar zyrën e ministrit të Arsimit dhe zyrave qendrore të MAS. "Jemi këtu pas disa muajsh që kanë kulmuar krizën e thellë të institucioneve të arsimit të lartë. E tillë ishte edhe lëvizja studentore e dhjetorit të kaluar. Aspekti i parë i kësaj krize duket qartë të financimi. Buxheti ka arritur në vitin 2019 në 3.29 për qind e PBB-së, në një kohë kur niveli minimal për të garantuar standardet rajonale, duhet të jetë jo më pak se 5 për qind. Këto para shkojnë në pjesën më të madhe për rikonstruksionin e Ministrisë së Arsimit, për një fasadë me të vërtetë lamburitë. Ndërkohë, rënia në pikiatë e financimit për arsimin e lartë shoqërohet edhe nga braktisja e studimeve. 133 mijë nxënës e studentë kanë braktisur shkollën në këto 4 vite", theksoi z.Basha. Sipas tij, qasja europiano-bashkëkohore do të jetë pikërisht ajo, që do të bëjë që arsimi shqiptar të udhëhiqet nga një koncept i ri menaxhimi, në financa, teknologji etj..

**DEKLARATA**

"Të vetmit që duhen të kenë frikë nga ardhja e Partisë Demokratike dhe opozitës në pushtet janë ata 5-6 oligarkë, të cilëve do t'ua marrim këto para dhe do t'ua japim rimisë shqiptare. Paratë që vjedhin oligarkët do t'ua marrim, kontratat do të anulohen, pasuritë e tyre të vëna në mënyrë të jashtëligjshme do të konfiskohen me ligjin e ri antimafia kundër oligarkëve dhe do t'u kthehen zotëve të vërtetë të këtyre parave", tha z.Basha.

**TRYEZA**

Kryetari i PD, Lulzim Basha, gjatë një bashkëbisedimi me pedagogë dhe përfaqësues të arsimit të lartë në vend deklaroi se universitetet në vend janë në krizën më të thellë në 29 vjet, ndërsa shtoi se buxheti për arsimin e lartë nuk shkon për infrastrukturë universitetesh, por për të rregulluar zyrën e ministrit të Arsimit dhe zyrave qendrore të MAS.

## ZGJEDHJET AKUZAT

Europarlamentarja: Luftoni që politikanët të mos blihen dhe të mos blejnë

# Kriza politike, Pack: Zgjidhja, përmes zgjedhjeve të lira

"Bandat e forta dëmtuan imazhin e Shqipërisë"

Valentina Madani

**E**urodeputetja Doris Pack hodhi akuza të forta ndaj shitblerjes së votës, ndërsa u kërkoi shqiptarëve dhe në mënyrë të veçantë të rinjve që të luftojnë këtë fenomen. Sipas saj, vetëm zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë zgjidhja e krizës aktuale. Përpara të rinjve shkodoranë, ndërsa referon te në Akademinë e Lider-shipit mbi temën "Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe roli i rinisë", kryetarja e grave të PPE, Doris Pack u ndal te situata politike, që kalon Shqipëria dhe rrezikun që i kanoset procesit integrues. "Problemi është se drejtësia është në dorë të politikës. Në momentin që kjo ndryshon, atëherë do ketë një sistem drejtësie që funksionon. Keni vettingun që shpresojmë të ndryshojë dhe të shohim politikan që futen në sistemin e drejtësisë dhe janë nga partitë politike dhe ata s'kanë asnjë mundësi tjetër, sepse do të duhet të dalin në gjykatë, por s'ka gjykatë dhe këtë nuk e kuptoj, prandaj duhet ta zgjidhni. Duhet të ketë një ndryshim në lidhje me sjelljen, sepse politika është pjesë e drejtësisë. Drejtësia nuk funksionon, është gabim", tha zj.Pack. Sipas saj, pa një drejtësi, demokracia është kukull. "Ndërkombëtarët dhe qytetarët duhet të çohen në këmbë, të ngrenë zërin dhe të ndryshojnë situatën. Njerëzit ikin për një jetë më të mirë dhe të sigurt jashtë, kjo po ndodh në vendin tuaj. Shpresoj të edukoheni edhe në vende të tjera, të arsimoheni dhe situata të ndryshojë në Shqipëri dhe të qëndroni në vendin tuaj. Vendi juaj ka nevojë për ju, për të kontribuar dhe nëse jeni të fortë, ju mund të ecni përpara. Kemi punuar që të kemi frymë Europe edhe në Shqipëri. Krijuar para disa vitesh një grup vullnetarësh dhe bëmë komisionin që duhej. Do më vinte keq që unë të rrisja nipat dhe mbesat e mia në një



Eurodeputetja Doris Pack

### THIRRJA

"Duhet të ndalohet blerja e votës, të bëjnë zgjedhje të drejta, sepse kjo nuk ndihmon. Duhet t'i nxirni, të luftoni për ndalimin e blerjeve të votave. Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë zgjidhja, duhet të keni regjistrin elektoral, që duhet të jetë i pastër. Ju duhet të luftoni që politikanët të mos blihen dhe të mos blejnë", - tha zj.Pack.

vend si Shqipëria. Politikanët po marrin shumë nga koha e këtij vendi dhe duhet që gjërat të bëhen siç duhet. Unë jam këtu, sepse më pëlqen Shqipëria, ju dua, i them gjërat dhe kritikoj shumë. Me z.Rama kam pasur diferencat e mia dhe ajo që më intereson është mirëqenia e qytetarëve. Nuk më interesojnë partitë dhe politika. Kush punon për mirëqenien, ajo është politika më e mirë. Edhe Basha po të jetë, do t'i them të njëjtat gjëra", - deklaroi zj.Doris Pack. Ish-eurodeputetja u ndal edhe te blerja e votës dhe situa-

ta kriminale, duke folur për banda të forta edhe në vendet europiane, që kanë ndikuar jo pak në imazhin e Shqipërisë. Lidhjet e tyre me politikën duhen shpërndarë. "Duhet të ndalohet blerja e votës, të bëjnë zgjedhje të drejta, sepse kjo nuk ndihmon. Duhet t'i nxirni dhe t'i luftoni për blerjen e votave dhe t'i ndaloni. Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë zgjidhja, duhet të keni regjistrin elektoral që duhet të jetë i pastër. Ju duhet të luftoni që politikanët të mos blihen dhe të mos blejnë. Kishte të pak-

tën 10 deputet që duhej të linin pozicionin e tyre për shkak të se shkuarës kriminale. Nuk mund t'i jepni shanset atyre që janë të kriminalizuar që të futen në parlament dhe këtë duhet ta ndaloni. Nuk mund të blihet, nuk mund ta blejnë dhe kjo nuk është demokracia e vërtetë. Ka politikanë që e bëjnë për para, natyrshëm që i duhen paratë, por jo ta kthejnë në prioritet. Në Belgjikë kishte banda që krijuan një imazh shumë të keq për Shqipërinë, nuk ka mbaruar këtu, janë gjëra që zgjasin. Ky është një vend në mes të BE-së dhe të vjen keq kur sheh që ka qeveri që shfrytëzojnë elektoratin e tyre, përdorin besueshmërinë", u shpreh zj.Pack. Eurodeputetja dhe raportuesja Doris Pack përkrah Lulzim Bashën gjatë një bashkëbisedimi me pedagogë dhe përfaqësues të arsimit të lartë në vend shprehur keqardhjen që universiteti në Shqipëri është i politizuar.

### SHKURT

## Meta takon presidentin Erdogan: Përpjekje të përbashkëta për paqe

**P**residenti i Shqipërisë, Ilir Meta, është pritur nga homoloгу i tij Rexhep Taip Erdogan në Turqi. Dy presidentët vlerësuan marrëdhëniet tradicionale të shkëlqyera mes dy vendeve e popujve dhe vullnetin e përbashkët për t'i zhvilluar ato më tej në të ardhmen. "Partneriteti strategjik midis dy vendeve është një platformë e shëndoshë, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit dhe përpjekjet e përbashkëta për paqe", theksoi z.Meta. Të dy presidentët e vunë theksin edhe në rritjen e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve. Po dje, Presidencia njoftoi se më 8-9 maj 2019, Presidenti Meta organizon në Tiranë Samitin e radhës së Liderëve të Procesit të Brdo-Brijunit. Procesi i Brdo-Brijunit është një nisimë rajonale bashkëthemeluar nga presidentët sllloven dhe kroat në vitin 2010. Me ftesën edhe të Presidentes së Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitarovi dhe të Presidentit të Sllovenisë, Borut Pahor, në Samitin e Tiranës do të marrin pjesë tre anëtarët e kryesisë së Presidencës së Bosnje-Hercegovinës, Milorad Dodik, Sefik Džaferović dhe Zeljko Komšić; Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi; Presidenti i Malit të Zi, Milo Çukanović; Presidenti i Maqedonisë, Gjorge Ivanov, si dhe Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić.

## Tabela greqisht në 5 bashki të jugut, PDIU: Kapitullim i shtetit para Greqisë

**V**endosja e tabelave në greqisht në të gjithë zonën e Sarandës, Delvinës e Konispolit, Finiqit e Dropullit përbën kapitullimin e plotë të shtetit shqiptar dhe një provokim të paprecedentë ndaj kombit tonë. Kështu thekson PDIU përmes një deklarate, ku ndër të tjera thekson se "Rilindja e pretendimeve 'vorioepirote' nën hundën e qeverisë Rama përbën skandalin më të rëndë të 30 viteve të fundit". Në deklaratë thuhet se, "Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet ndan shqetësimin e sarandjotëve, delvinjotëve, konispolatëve por edhe Finiqit e Dropullit e çdo shqiptari që po sheh ditën me diell mosveprimin e turpshëm të qeverisë e prokurorisë përballë akteve të rënda kundër sovranitetit kombëtar. Nëse qeveria shqiptare nuk ndërhyrë në kohë, tregon se ka gisht në cenimin e sovranitetit të vendit. Çdokush të jetë i qartë se shqiptarët nuk do të rrinë duarkryq përballë këtij skandali dhe për pak ditë kjo shëmti do t'i përkasë historisë! PDIU i bën thirrje kryeministrit Rama, prokurorës Marku, ministrave Lleshaj dhe Cakaj, të mos bëhen bashkëpunëtorë të Jorgji Zografit, përpara se të jetë vonë! Greqishtja është gjuhë e dytë vetëm në Finiq e Dropull dhe atje tabelat duhen fillimisht në gjuhën shqipe, pastaj në greqisht. Ndërsa vendosja e tabelave greqisht në zonat e tjera është e palejueshme dhe duhet urgjentisht ndërhyrja e prokurorisë dhe qeverisë", thuhet në deklaratën e PDIU.



### NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me perbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e pare për pasurinë :

1- "ARE", me sipërfaqe totale 261.00 m<sup>2</sup> , e ndodhur në Q/Ë Kamëz, Rrethi Tiranë , në Zonën Kadastrale 2086 , Numri i Pasurisë: 93462, Vol. 45, Faqe. 63, në pronesi të Tatjana Man Allushi dhe Hasan Sulejman Allushi. Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 1.000.000 (një milion) . LEKË

Ankandi i pare për pasurinë e mesipërme zhvillohet me datë 15.05.2019 , ora 16:00 në ambientin e Zyrës së perbaruese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 0699381883 .

### NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me perbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e trete për pasurinë :

1- "Truall", me sipërfaqe 250 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtese 85m<sup>2</sup> , e ndodhur në Bittinck, Devoll, në Zonën Kadastrale 1202, Numri i Pasurisë: 183150, Vol. 20, Faqe. 70, në pronesi të Vasil Ferit Muceku.Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 630.000(gjasthëqind e tridhjetë mijë) LEKË

Ankandi i trete për pasurinë e mesipërme zhvillohet me datë 23.05.2019 , ora 16:00 në ambientin e Zyrës së perbaruese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 0699381883 .

## Zgjidhen problemet teknike në Rrugën e Kombit

### Rruga Kukës-Morinë, gati përpara sezonit turistik

Punimet në rrugën Kukës-Morinë do të përfundojnë përpara nisjes së sezonit turistik, në mënyrë që të lehtësohet qarkullimi i turistëve, të cilët zgjedhin Shqipërinë për të kaluar pushimet verore. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, e shoqëruar nga drejtoresha e Autoritetit Rrugor Shqiptar, Sonila Qato inspektojnë kantieret ku po kryhen punimet përgjatë rrugës, ku u njohën nga afër me problematikat që janë ndeshur gjatë ndërtimit si dhe masat për eliminimin e tyre. "Ka pasur një vonesë, një vështirësi për shkak se asnjë lloj vinçi që ekziston në rajon nuk e merrte përsipër dhe

kontraktori është detyruar të prodhojë një vinç enkas për t'i transportuar nga viaduktet e dubluara, për t'i hedhur në viaduktin që po dublohet. Vështirësia kryesore ka qenë se ky viadukt është me pendencë, ka pjerësi gjatësore dhe duhet të balancohej vinçi se çdo luhajtje sado e vogël dilte çdo gjë jashtë kontrollit", ka shpjeguar njëri prej inxhinierëve të ARRSH-së. Tashmë edhe kjo situatë është kapërcyer dhe përfundimi i kompanisë që po realizon punimet siguroi se ritmet e punës janë të larta, për të bërë të mundur dorëzimin e

objektit në afat. "Siç shikohej, është hapësira e fundit e këtij viaduktit, pra vështirësi më në fund kanë përfunduar dhe ne do të punojmë me ritme shumë të larta për të arritur objektivin tonë që kjo rrugë të përfundojë brenda afatit kontraktual. Siç do e shikojmë, është dhe një kontratë tjetër për rakordimin e viadukteve, për të cilat sot dhe në vazhdim jemi duke punuar me asfaltimin e hyrje-daljeve", deklaroi përfaqësuesi i kompanisë kontraktuale. Nga ana e saj, drejtoresha e ARRSH-së, Sonila Qato tha se financimi për përfundi-

min e punimeve është i plotë dhe tashmë i buxhetuar dhe se punimet nuk do të ndalen deri në përfundimin e tyre. "Këtu flitet për rehabilitim dhe vënie në funksion të mjeteve dhe të përdoruesve të rrugës në 12 kilometra, të cilat neve synojmë që t'i vënë më punë sa më shpejt. Sigurisht edhe këtu kemi pasur disa probleme teknike, të cilat jemi duke i shikuar me specialistët tanë në Autoritetin Rrugor Shqiptar për t'i kaluar, me qëllim që të mbajmë ritmin e punës njësoj si dy viaduktet e tjera, që janë duke u ndërtuar më tej dhe për ta hapur



këtë segment rrugor në fillim të sezonit turistik", deklaroi Qato. Ministria Balluku kërkoi nga përfaqësuesit e firmës kontraktuale përfundimin brenda afateve të parashikuara të punimeve, duke e vënë e theksin të rëndësia e këtij aksi, veçanërisht në sezonin e verës për qytetarët e Kosovës, të cilët i drejtohen bregdetit shqiptar. "Ju duhet

të bëni të pamundurën për të kapur afatet. Ky është një aks kombëtar shumë i rëndësishëm. Do ishte mirë që gjatë sezonit kjo pjesë të ishte dorëzuar për të mos krijuar dhe probleme në trafik, i cili vjen edhe nga Kosova apo edhe vizitorët që janë shtuar kohët e fundit dhe vijnë në zonën e Kukësit", u shpreh Balluku.

Kryeministri Rama: Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, besim te strategjia jonë

# BERZH dhe Bashkimi European, 100 mln euro për turizmin

Ambasadori i BE-së në Tiranë, Soreca: Investoni siç duhet

Banka Europiane dhe Banka për Rindërtim dhe Zhvillim kanë dhënë 100 milionë euro për zhvillimin e turizmit në Korçë, Berat, Fier dhe Shkodër. Ambasadori i Bashkimit European në Tiranë, Luigi Soreca vlerësoi Shqipërinë si një vend me potencial zhvillimi në fushën e turizmit, por i kërkoi qeverisë që të bëjë kujdes në strategjinë e investimeve në këtë sektor. "BE po investon 40 milionë euro në zhvillimin e turizmit për të nxjerr konkurrencën dhe zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, duke i dhënë vlerë bukurisë saj natyrore dhe pasurive kulturore. Por, duhet bërë kujdes pasi nëse nuk investohet siç duhet, mund ta shkatërrojë turizmin në vendin tonë", - Luigi Soreca. Këtë mbështetje, kryeministri Edi Rama e cilësoi si besim të institucioneve ndërkombëtare ndaj strategjisë së qeverisë. Kryeministri Edi Rama e ka cilësuar kontributin me 100 milionë eurosh nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për turizmin në Shqipëri dhe BE, një shprehje të besimit e vlerësimit të strategjia e përzgjedhur prej qeverisë shqiptare përmes rilindjes urbane.

#### PROJEKTI

Në prezantimin e projektit të përbashkët të Bashkimit European dhe BERZH me 100 milionë euro në mbështetje të programit transformues të turizmit në Shqipëri, kreu i qeverisë tha se këto dy forca kanë një kontribut të madhe për vendin tonë. "Nuk ka diskutim që Shqipëria s'do ishte i njëjti vend pa mbështetjen e BE dhe BERZH gjatë më shumë se 25 viteve të fundit. Janë me dhjetëra e dhjetëra projektet, që janë mundësuar në vendin tonë falë mbështetjes financiare të BERZH, ashtu sikundër është më se e vërtetë që edhe projekti që lançojmë sot si një projekt i përbashkët mes BE-së dhe



Ambasadori i Bashkimit European në Tiranë, Luigi Soreca

BERZH përbën jo vetëm shifër 100 mln euro, por mbi të gjitha në përmbajtjen e vet, një arsye më shumë për të vlerësuar rolin dhe kontributin e jashtëzakonshëm në vendin tonë të këtyre dy forcave. Kjo marrëveshje e re, e cila do t'i shkojë si një mbështetje më shumë programit tonë transformues të turizmit në Shqipëri është edhe një shprehje kuptimplotë e vlerësimit dhe besimit të këtyre institucioneve tek rruga dhe strategjia e përzgjedhur prej nesh përmes rrugës së rilindjes urbane dhe asaj urbane", deklaroi Rama. Ai theksoi se është një projekt, i cili para se t'i jepnim formë programit kombëtar të rilindjes urbane, do të ishte i pamundur sepse baza e argumenteve që është

krijuar falë suksesit të programit të rilindjes urbane nuk do të ishte aty. "Çka po diskutim me presidentin e BERZH-it pak më parë ishte pikërisht se çfarë përpjeksh transformuese kanë sjellë ndërhyrjet e integruara, që kanë ndryshuar këndvështrimin e komunitetin e tyre në raport me vendbanimin e tyre dhe vetveten. Nuk bëhet një fjalë për një fond që do shkojë për një komponent, por do shkojë për programe të integruara dhe do t'i bashkëngjitet një harte ndërveprimesh të përcaktuara dhe do t'i bashkëngjiten edhe fonde të tjera qoftë nga buxheti i shtetit, qoftë nga BB, apo që në hapat në vijim pritet të vihen në dispozicion edhe nga banka gjermane", theksoi kreu i qeverisë. Ai tha se Shqipëria ka dy-

fishuar numrin e turistëve në 5 vjet dhe se ky numër është rritur edhe në raport me një vit më parë. "Në fjalën e sotme ministri i Turizmit dhe Mjedisit ishte optimist që në 5 vjet kemi arritur të dyfishojmë numrin e turistëve. Kur them ne, Shqipëria ka arritur ta dyfishojë. Ne kemi pasur një rol jo të vogël në këtë rritje. Duke parë sot shifrat e prillit në krahasim me një vit më parë, kemi përsëri një rritje. Duke krahasuar dhe 4 muajt e këtij viti me 4 muajt e parë të vitit të kaluar, kemi përsëri një rritje. Sa më shumë turistë, aq më shumë njerëz do të kemi jashtë vendit tonë, do të thonë të vërtetën për Shqipërinë, e cila ka vuajtur dhe vuan nga perceptimet e krijuara pa e njohur atë nga afër", tha Rama.

## Raporti i bankave

### Në dy muaj fituan 3.6 miliardë lekë

Sistemi bankar e ka nisur me performancë financiare pozitive vitin 2019. Mbështetur në të dhënat e Bankës së Shqipërisë, për dy muajt e parë të vitit sistemi arriti një fitim prej afro 3.6 miliardë lekësh. Krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë, fitimi është rritur me rreth 70%. Në terma të kthimit nga kapitali, përfutueshmëria e sektorit bankar ka arritur në 14.4%, nga 8.6% që kishte qenë në dymujorin e parë të vitit të kaluar. Performanca e sektorit bankar është pozitive dhe e qëndrueshme në vitet e fundit. Kryesisht, kjo ka ardhur si rezultat i uljes graduale të raportit të kredive me probleme, që tashmë është afërsisht në nivelet e 11%, ndërsa gjatë viteve të krizës kishte arritur në kufijtë e 25%. Por në fakt, analiza e performancës së bankave është më komplekse. Rezultatet në nivel sistemi mbështeten në standardet e mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë. Ligjërisht, bankat raportojnë me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar. Trajtimi i ndryshëm i provigjioneve nga dy sistemet e raportimit bën që rezultatit financiar shpesh të ketë diferencën shumë të mëdha. Vitin e kaluar, Banka e Shqipërisë vlerësoi se fitimi i sistemit ishte 18.4 miliardë lekë, por rezultatet e raportuar nga secila bankë treguan një fitim prej rreth 8.2 miliardë lekësh. Mes bankave kanë ndryshime të konsiderueshme. Mbështetur në shifrat e raportuara përmes Shoqatës së Bankave, shtatë banka e mbyllën vitin 2018 me fitim, pesë me humbje, ndërsa dy nuk i kanë publikuar ende treguesit financiarë për vitin e plotë.



# PRONARET KOMPENSIMI

Ndërtimet pa leje, marrin tapitë për truallin 1000 përfutues, sipërfaqet që legalizohen

## Agjencia e Kadastrës, 105 milionë lekë për 300 pronarë

Përfutuesit në Tiranë, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër

Qeveria miraton një fond prej 105 milionë lekësh për kompensimin e 300 pronarëve, që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Në të njëjtin vendim është miratuar edhe kalimi i pronësisë për truallin mbi të cilin është ndërtuar. "Masa e kompensimit financiar për pronarët e pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimet e legalizuara, referuar kartelave të pasurive sipas Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme është 10 993,97 m<sup>2</sup> dhe vlera totale e kompensimit financiar është 105 224 873 lekë", - thuhet në vendim. Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare dje. Ndërkohë është miratuar kalimi i së drejtës së pronësisë, në favor të sub-

jektëve përfutuese, për 633 prona me rreth 1000 pronarë. Vlera kompensimit financiar për pasuritë vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronës, e cila bën të ditur listën me përfutuesit.

### TAPITË

Këshilli i Ministrave

miratoi të mërkurën edhe kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre. Sipas vendimit të qeverisë, mësohet se për qarkun Elbasan (ZVRPP

Elbasan, Peqin, Librazhd), janë pajisur me tapitë 163; për qarkun Durrës (ZVRPP Durrës), 24; për qarkun Tiranë (ZVRPP Tiranë dhe Kavajë), 174; për qarkun Fier (ZVRPP Lushnjë), 20, për Shkodrën 9; për qarkun Vlorë (ZVRPP Vlorë dhe Sarandë), 186; për qarkun

Gjirokastrë 45; për qarkun Lezhë 9; për qarkun Kukës dhe për qarkun Korçë nga një. Këshilli i Ministrave urdhëron Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, Elbasan, Librazhd, Durrës, Tiranë, Lushnjë, Shkodër, Korçë, Lezhë, Vlorë, Sarandë,

Gjirokastrë, Kavajë dhe Kukës të regjistrojnë brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kalimin e së drejtës së pronësisë së parcelave ndërtimore dhe hipotekën ligjore mbi to. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

66	ERALDA	SABRI	DACI	31615223	20/12/2017	SHTETER	
67	HABIBE	BAJRAM	DACI	806013813	18/12/2017	SHTETER	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8524</b>							
68	HALIT	HASAN	GJINI	35659584	18/12/2017	SHTETER	
69	SANJE	SABRI	GRYKSHI	6658985	28/07/2017	SHTETER	
70	NIKOLLA	PETRAQ	GJOKA	2578731	28/03/2018	SHTETER	
71	VALENTINA	OSMAN	GJOKA	2578732	28/03/2018	SHTETER	ORE
	ERVIN	THASAN	GJOKA				
	TOMORR	HALIT	DEBROVA				
	ALEKS	KOL	QOSJA			SHTETER	
72	BARDHUL	SHEFQET	CANI	2578720	27/03/2018	ORE	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8525</b>							
73	AGRON	QAZIM	FLIJA	85154521	20/11/2017	SHTETER	
74	QEMAL	RAMAZAN	TUSHA	2578677	19/03/2018	SHTETER	ORE
	MEREME	SELM	TUSHA				
75	BESIM	SALI	FIRAKU	2010001	10/1/2017	SHTETER	ORE
	SHEFIKAT	XHEMAL	FIRAKU				
	HATIXHE	RIZA	STAJA				
	NERTILA	IBRAHIM	STAJA				
	LEDJAN	IBRAHIM	STAJA			SHTETER	
76	SIDORELA	IBRAHIM	STAJA	58598710	29/09/2017	ORE	
77	FILIP	PALI	BERDUFI	2578675	16/03/2018	SHTETER	
<b>Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar</b>							
Nr. rendor	Emër	Atësi	Mbiemë	Leja e legalizimit		juridike (pronesi a)	Pjesa takuese në parcele
				Numer	Date		
1	2	3	4	5	6	7	8
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2446</b>							
78	DILAVER	HAQIF	GJOKOLA	7070026	29/12/2016	SHTETER	
79	NDRIÇIM	MUHAME	HYSA	309052	15/04/2017	SHTETER	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 2523</b>							
80	BEHXHET	HAZEM	SHERMADH	9999962	10/8/2016	SHTET	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3294</b>							
81	ZARIF	QAZIM	DELIU	2578931	21/04/2018	SHTET	
82	ELMAS	QAZIM	DELIU	2578932	21/04/2018	SHTET	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3422</b>							
83	MERITA	PETRIT	SALLA	29327441	30/01/2018	SHTET	
84	KRISTAQ	KOST	ÇIFI	2578779	16/04/2018	SHTET	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2696</b>							
85	NDRIÇIM	ABEDIN	MURATI	809036	9/5/2017	SHTET	
86	ISMET	ABDULLA	HOXHA	809037	9/5/2017	SHTET	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 1363</b>							
87	ENVER	LATIF	ÇELA	8585845	27/12/2017	Shtet	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 2093</b>							
88	ISLAM	MURAT	METALLA	1020789	10/11/2016	Shtet	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 2103</b>							
89	RAMAZA	CAUSH	TABAKU	3638957	19/12/2017	Shtet	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 2490</b>							

90	LEONARD	BEHAR	KOLA	7789632	29/04/2016	Shtet	
91	NESTI	AHMET	XHAJA	3030365	20/03/2017	Shtet	
92	ÇLIRIM	AHMET	XHAJA	3030364	20/03/2017	Shtet	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 2856</b>							
93	TASIM	SALI	PLAKU	58528001	6/11/2017	Shtet	
94	KUJTIM	ASLLAN	KRECI	998532	5/4/2016	Shtet	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 2860</b>							
95	DASHAMIR	FAIK	FERHATI	202046	10/3/2017	Shtet	
96	FLORI	NEXHIP	BEQIRI	3737201	13/11/2017	Shtet	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 2892</b>							
97	JASHAR	ADIL	SALLA	9963214	7/4/2016	Shtet	
	ERMIR	JASHAR	SALLA				
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 2908</b>							
98	BUJAR	NUH	GJELI	5050311	14/09/2016	Shtet	
99	ENKLED	QEMAL	DUBALI	1020325	10/11/2016	Shtet	
100	ZENEL	RRAPUSH	JAKUPI	9963940	30/05/2016	Shtet	
<b>Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar</b>							
Nr. rendor	Emër	Atësi	Mbiemë	Leja e legalizimit		juridike (pronesi a)	Pjesa takuese në parcele
				Numer	Date		
1	2	3	4	5	6	7	8
101	BRUNO	KUDRET	ELEZI	5050238	10/9/2016	Shtet	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 2921</b>							
102	ARBEN	ALUSH	SHOTI	59658574	1/11/2017	Shtet	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 3715</b>							
103	DURIM	PULLUMB	BEGA	60601315	11/12/2017	Shtet	
104	ENGJELL	PULLUMB	BEGA	3061378	13/12/2017	Shtet	
105	XHEVDET	HAJDAR	SALLIU	5758068	17/10/2016	Shtet	
106	KRISTO	HYJNI	GUNA	809005	8/5/2017	Shtet	
107	REXHEP	SHAHIN	HAKA	898959	20/10/2017	Shtet	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 1715</b>							
108	SHPËTIM	RRUZHDI	CEKU	309066	18/04/2017	SHTET	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2446</b>							
109	REXHAI	KASEM	BASHLLARI	3030354	20/03/2017	SHTETER	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 1177</b>							
110	SHERBET	HALIT	BIXI	5050274	13/09/2016	Shtet	
111	MYFTAR	REFAT	BIXI	1020817	14/11/2016	Shtet	
112	AQIF	RAMAZAN	BIXI	7070710	1/11/2016	Shtet	
113	NEVRUZ	RAKIP	BIXI	6060990	31/10/2016	Shtet	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 1363</b>							
114	ARJAN	BEDRI	KARINA	4020805	15/12/2016	Shtet	
115	BEDRI	HASIR	KARINA	4020803	15/12/2016	Shtet	
116	ALBERT	DEMIR	SULI	6060987	31/10/2016	Shtet	
117	RAMAZA	RIZA	SHABANI	3040559	16/12/2016	Shtet	
<b>QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 1748</b>							
118	SERVEI	NYRTEZA	ELEZI	3040558	16/12/2016	Shtet	
119	HASAN	RESHIT	HARREMI	4020912	12/12/2016	Shtet	
120	KADRI	AQIF	HIDRI	6060459	31/10/2016	Shtet	

QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 2471							
Nr. vendos	Emër	Atëz	Mblomë r	Leja e legalizimit Numer	Date	Jurisdik (pronësia)	Pjesë ta kus se në parqe
122	MUHAMET	XHIBALI	SINANI	10203/3	10/11/2016	Shtet	
123	TAFIK	ILYLYF	QELMETA	70707/0	7/11/2016	Shtet	
124	HYRRI	RIKAR	KO A	77964/1	28/04/2018	Shtet	
QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 3686							
125	KLUTM	SEFQET	URÇI	60611/0	31/10/2016	Shtet	
QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE 3716							
126	EMILHA	RAMAZAN	BALIU	67620/6	16/10/2016	Shtet	
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8521							
	OLGIN	KAMER	Z'ABELI				
						PRONAR (298.1 m <sup>2</sup> ), SHTET (69.8 m <sup>2</sup> )	
	SHUKUL	ABDULLI	SANKHAQT	25/9/104	1/10/2018		
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1407							
128	VATHI	DEJIR	DRZI	8181000	24/04/2017	SHTETER	
	YMER	RAKIP	TASHI				
	URILIAN	YMER	IAZHI	8181026	1/3/207	SHTETER ORE	
	YMER	RAKIP	TASHI	8181026	3/3/207	SHTETER ORE	
	DRITAN	YMER	TASHI				
	YMER	RAKIP	TASHI	818124	1/3/207	SHTETER UJTE	
	URILIAN	YMER	IAZHI				
132	DRITAN	YMER	TASHI	309077	19/04/2017	SHTETER	
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 2124							
133	LEDONDA	HAMIT	BALIU	85857/5	29/06/2017	SHTETER	
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3371							
134	SOKRAT	DIMITER	TOLI	50505/1	17/09/2016	SHTETER	
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3373							
135	MYFTVA	SHILBATER		1031000	30/11/2016	SHTETER	
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3833							
136	FADIL	SHABAN	PRECI	309075	19/04/2017	SHTETER	
137	OLTUAN	BARDHYL	HOXHA	3090134	20/04/2017	SHTETER	
138	MYFTVA	TREBAN		1030134	26/11/2016	SHTETER	
Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar							
Nr. vendos	Emër	Atëz	Mblomë r	Leja e legalizimit Numer	Date	Jurisdik (pronësia)	Pjesë ta kus se në parqe
1	2	3	4	5	6	7	8
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2096							
139	BEENIK	REBAT	BULOZHINI	30309/0	29/08/2016	SHTETER	
140	GANI	DANUSHI	FUETRI	3030607	31/03/2017	SHTETER	
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2248							
141	FERDON	XHEVAR	ALLKO	5225221	7/11/2017	SHTETER	
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2924							
142	MEHMET	DANI	HANA	307019	31/03/2017	SHTETER	
143	VALBONA	NAZMI	GULASI	8899011	9/7/2016	SHTETER	
144	GEZM	XHIBAL	KACA	968571	15/07/2016	SHTETER	
145	MILHARRI	MIRA	ALLKO	498841	24/01/2018	SHTETER	
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2925							
146	YLLI	SHAHN	KUKLI	385066	31/03/2017	SHTETER	
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 3120							
147	ILAVDI	MUJARRRRI	MORJANI	306079	20/03/2017	SHTETER	
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 3203							
148	NKO	DIMITER	GULASI	309056	22/04/2017	SHTETER	
149	SYRJA	SBT	FACIA	4050117	27/12/2016	SHTETER	
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1147							
150	FITNETE	IBIBAL	SHTYLLA	8585154	28/12/2017	SHTET	
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1386							
151	VELI	XHILE	QYRA	2578937	24/04/2018	SHTET	
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1616							
152	DURIM	AHMET	IBIBALI	302050	13/03/2017	SHTET	
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1853							
153	SHPETIM	ZENE	KOÇU	8184107	18/02/2017	SHTET	
154	SALI	FILE	RUSTA	3030588	16/03/2017	SHTET	

154	HYSEN	NJRI	RUSTA	3030661	13/03/2017	SHTET		
156	HYSEN	NJRI	RUSTA	1002056	11/3/2017	SHTET		
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3212								
157	KADRI	IBIBAL	RAJA	808092	26/01/2017	SHTET		
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3213								
158	SKENDER	MAHMUT	META	302060	2/2/2017	SHTET		
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3223								
159	RRAPUSH	MESUT	BOLLAKU	8181214	24/02/2017	SHTET		
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3393								
160	SEFEDIN	DRZ	PEPA	8857706	21/08/2016	SHTETER		
DREJTORIA EALUZHINI-DURRES								
Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar								
Nr. vendos	Emër	Atëz	Mblomë r	Leja e legalizimit Numer	Date	Jurisdik (pronësia)	Pjesë ta kus se në parqe	
1	2	3	4	5	6	7	8	
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8518, ZVRPP DURRES								
	ESMERLLO	BAJRAM	SALLARI					
	XHORGH	JANI	NKA	269558	31.05.2018	SHTET		
162	BASHKIM	NOVRLE	MULELLAR	2260132	3/03/2017	SHTET		
163	ALFRED	XHEVDET	SEFERI	2689322	6/09/2017	SHTET		
164	ZYDI	REFK	HALLI	2199471	2/07/2016	SHTET		
165	MUSA	FEJZI	ELEZI	1550850	4/04/2016	SHTET		
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8516, ZVRPP DURRES								
166	ALUFLOR SHRK Nr.268851 Dt.31.08.2017							SHTET
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8512, ZVRPP DURRES								
167	FLORANT	QBIAL	MANSAKU	1643012	5/05/2017	SHTET		
	LILJANA	XHEBAR	CANI					
	ILR	DIEL	CANI	1643732	5/05/2017	SHTET		
	FATMIR	MEHMET	ASLANAJ					
	DAJLAN	MEHMET	ASLANAJ	2216030	5/08/2016	SHTET		
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 3369, ZVRPP DURRES								
170	SKENDER	SULEMA	SHAHNI	268893	13.09.2017	SHTET		
171	SEFQET	AHMET	SHABA	269212	28.03.2018	SHTET		
172	FATMIR	VATH	MIANO	269214	28.03.2018	SHTET		
173	HASAN	HAMID	VEZI	269219	28.03.2018	SHTET		
	RAME	SHABAN	ADBI					
	EDIRA	FADIL	BERISHA					
	LUAN	FADIL	ADBI					
	TRENDAFLE	FADIL	SHKOZA	269216	28.03.2018	SHTET		
175	SHABAN	LUFTA	KECI	269217	28.03.2018	SHTET		
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 2585, ZVRPP DURRES								
	LEONARD	FATMIR	MUCA					
	RUDOLF	FATMIR	MUCA	262965	07.04.2017	SHTET		
DREJTORIA EALUZHINI - KAM EZ-VORE								
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3993								
							TE TRETVE 3 (46.5)	
	SALI	ELEZ	MERAJ	70209363	22/02/2018			
Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar								
Nr. vendos	Emër	Atëz	Mblomë r	Leja e legalizimit Numer	Date	Jurisdik (pronësia)	Pjesë ta kus se në parqe	
1	2	3	4	5	6	7	8	
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 1701								
182	SURE	SHABAN	GERDECI	70209473	15/03/2018	SHTET	20	
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 1649								
183	FERDE	AHMET	GOXHAJ	70209372	22/02/2018	TE		
	BLERM	AHMET	KORTOÇI	702010165	16/05/2016	TE		
	GLXIM					TRETVE 1		
185	XHIBIL	REXHEP	BRAMIAJ	70203428	16/06/2016	SHTETER		
186	ARANIT	SALI	PERVANA	70203672	29/06/2016	SHTETER		



## Operacioni antikanabis, monitorim nga ajri i të gjithë territorit të Shqipërisë

**TIRANË** - Ministria e Brendshme bën me dije se së shpejti Task-Forca Qendrore do të nisë monitorimin nga ajri të të gjithë territorit të Shqipërisë, për të shkatërruar çdo sipërfaqe toke të mbjellë me bimë narkotike. Në këtë kuadër, në Ministrinë e Brendshme u mbajt takimi i radhës së Task Forcës Qendrore, në kuadër të zbatimit të

planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020. Në mbledhje u diskutua mbi masat e ndërmarra, rezultatet dhe arritet konkrete të institucioneve anëtare të TFQ-së. Fokus i këtij takimi krahas masave dhe aktiviteteve të kryera si pjesë e detyrimeve, ishin edhe paraqitja e problematikave të hasura, si dhe nevo-

jat për kapacitete logjistike në përmbushje të detyrave të tyre. Zv.ministria e Brendshme, Rovena Voda kërkoi bashkëpunim më të ngushtë dhe më intensiv gjatë kësaj periudhe ndërmjet institucioneve qendrore pjesë e Task-Forcës, për të shkëmbyer informacion për raste kultivimi ose trafikimi, si dhe kryerjen e operacioneve të për-

bashkëta ndër-institucionale. Gjithashtu, anëtarët theksuan domosdoshmërinë e një koordinimi edhe më të mirë, me qëllim parandalimin në kohë dhe goditjen me efikasitet të çdo rasti të kultivimit të kanabisit. Së shpejti, kontroleve të territorit nga Policia e Shtetit dhe inspektoratete të ndryshme do t'i shtohen edhe monitorimi përmes fluturimeve ajrore, mundësuar nga projekti "Sancas" i financuar nga BE.

## Vendimi, gjykata e Kurbinit lë në arrest me burg dy të akuzuarit

### KURBIN

**G**jykata e Kurbinit ka lënë dje në burg 3 autorët e dyshuar të vrasjes së dy kushërinjve Kelvin dhe Erjon Jushi në Laç. Ngjarje kjo e ndodhur një javë më parë në lagjen nr.1 të këtij qyteti. Tre të akuzuarit Manuel Bushi, Markel Bushi dhe Vincent Bushi, të cilët u dorëzuan pak ditë më parë në polici pas negociatave me familjarët, kanë mbërritur në gjykatë nën masa të rrepta sigurie. Gjatë seancës së djeshme gjyqësore që u zhvillua me dyer të mbyllura, dy nga të pandehurit janë shprehur të penduar në lidhje me vrasjen e dy kushërinjve Jushi, ndërsa Manuel Bushi ka heshtur. Markel Bushi është shprehur para togave të zeza se është penduar. "Jam penduar për atë çfarë kam bërë, unë nuk kam dashur që t'i vras". - ka thënë ai, ndërsa ka shpërthyer në lot në gjyq. Ndërkohë që Vincens Bushi ka treguar se dy kushërinjtë në sherr e sipër e kanë goditur me sende të forta. "Na goditën me sende të forta, ndaj ka agravuar situata deri në përdorimin e armëve", - ka pohuar ai.

### NGJARJA

Kelvin dhe Erjon Jushi u vranë mbremjen e 28 prillit në Laç. Sipas policisë, vrasja ndodhi për motive banale pas një konflikti të castit. Shërr verbal për motive të dobëta nisi brenda ambienteve të një lokali mes kushërinjve Kelvin dhe Erjon Jushi me Manuel Bushin. Ky i fundit më pas ka thirrur edhe vëllain e madh me kushërinin, të cilët erdhën në lokal të armatosur. Kushërinjtë Jushi tentuan t'i shmangen përplasjes me armë dhe dolën në rrugë, por nuk mundën t'i shmangeshin breshërisë së plumbave. Ata mbetën të plagosur dhe u transportuan në Tiranë për ndihmë mjekësore, por nuk mundën t'u mbijetonin plagëve të marra. 30-vjeçari Kelvin Jushi është një personazh i njohur në Laç, pasi në periudhën 2009-2014 ka qenë futbollist me ekipet e Laçit, Kastriotit dhe Mamurrasit. Njëri prej autorëve të dyshuar, 25-vjeçari Markel Bushi është person me precedentet penale dhe në kërkim nga policia që në vitin 2013, pasi



Vendi ku ndodhi vrasja e dyfishtë në Laç

akuzohet për grabitje me armë. Në vitin 2012 ai së bashku me një person tjetër kanë sulmuar me armë disa vajza dhe i kanë grabitur. Për këtë ngjarje ai u arrestua nga policia dhe mundi të arratisë disa muaj më vonë nga burgu dhe u dënua në mungesë nga gjykata me 9 vite burg. Policia ka tentuar edhe në 2013-


ën ta arrestojë sërish, por ai është kundërpërgjigjur me armë dhe ka mundur t'u shpëtojë prangave. Me precedentet penalë është edhe autori tjetër i dyshuar 28-vjeçari Vincens Bushi. Ai ka qenë i arrestuar dhe dënuar në 2017-ën për armëmbajtje pa leje, ndërsa është liruar nga drejtësia me shërbim prove.

Fillimisht ai u dënua me 6 vite burg, për shkak të gjykimit të shkurtuar iu ul masa në 1/3 dhe 2 vitet që i mbeten iu lanë në shërbim prove. Bashkia Kurbinit dërgoi në gjykatë një letër me arsyetimin se Pali ka sjellje të mirë në komunitet.

### NGJUMI

Edhe pse 3 autorët e dys-

huar për vrasjen e dy kushërinjve në Laç tashmë ndodhen në burg, frika për ndonjë hakmarrje të mundshme ka bërë që familjarët e tyre të ngujohen. Nuk bëhet fjalë vetëm për familjet e Markel, Manuel e Vincens Bushit, por edhe kushërinjtë të tyre të afërt. Edhe pse tre të dyshuarit për vrasjen e Erjon dhe Kelvin Jusht janë në pranga, burrat dhe gratë e dy fiseve u janë nënshtruar zakoneve të tyre pas ngjarjes. Fillimisht, sa u përhap lajmi, u mbyllën brenda afro 20 shtëpi. Por, më pas, sipas zakonit, të ngujuar qëndrojnë vetëm familjet e autorëve dhe ata më të ngushtë në rreth familjar nga rrenjë e babait. Ndërsa fisi nga nëna ndihmon në zgjidhjen e problemeve. Për këtë arsye, ishte daja ai që negocioi me shefin e Komisarariatit të Kurbinit, gjë që u pasua me vetëdorëzimin në polici të tre djemve të fisit Bushi.



Kapet në Rinas 38-vjeçari me mijëra euro 'cash' të padeklaruar

**TIRANË** - Policia Kufitare në Rinas ka ndaluar në kontroll një 38-vjeçar që do të largohet nga Shqipëria me një shumë parash 'cash' me vete të padeklaruar. Sipas të dhënave zyrtare, në kuadër të masave të përbashkëta të marra mes Policisë Kufitare dhe autoriteteve doganore për rritjen e masave në drejtim të forcimit të kontrollit me qëllim parandalimin, evidencimin dhe goditjen e paligjshmërisë, gjatë paradites së sotme është evidencuar dhe goditur një tjetër rast i transferave të parave në mënyrë të paligjshme jashtë vendit. Gjatë kontrollit në vijën e dytë të shtetasit J.S. 38 vjeç, i cili do të udhëtonte për jashtë vendit Policia Kufitare në bashkëpunim me doganën, i gjeti këtij shtetasi 26500 euro të padeklaruar në doganën e Rinasit, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale. Në përfundim të veprimeve, materialet do t'i kalojnë për veprime të mëtejshme prokurorisë për veprën penale "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë".

## Procedohet penalisht edhe kryeplaku i fshatit

## Sekuestrohen municione, kokainë dhe kanabis gjatë operacionit "Liqeni", një në pranga

**TEPELENË** - Municione, doza kokaine, fara e kubikë kanabis ka zbuluar policia në Tepelenë, duke arrestuar një person dhe proceduar penalisht kryeplakun e fshatit Vasjar. Policia e Tepelenës dhe ajo e Gjirokastrës kanë finalizuar me sukses operacionin e koduar "Liqeni" duke goditur dy raste të tentativës për kultivim të bimëve narkotike si rezultat i kontroleve dhe falë informacioneve të ardhura nga qytetarët. Si rezultat i operacionit u bënë arrestimi në fla-

grancë i shtetasit M.J., 26 vjeç, banues në Sarandë. I riu u kap në flagrancë nga shërbimet e policisë në vendin e quajtur "Liqeni i fshatit Levan", Memaliaj, ku në cilësinë e provës materiale, policia sekuestrooi disa doza me lënë të dyshuar kokainë, një sasi të konsiderueshme fara kanabis sativa si dhe kubikë të kultivuar me fara kanabis. Vijnë puna për dokumentimin e plotë të

këtij aktiviteti kriminal dhe identifikimin e personave të tjerë të implikuar. Gjithashtu, po në kuadër të kontrollit të pandërprerë të territorit, si pasojë e presionit të policisë duke ushtruar kontroll të pandërprerë, në një zonë të pyllëzuar në territorin e fshatit Vasjar, nga shërbimet e policisë Memaliaj gjatë kontrollit të territorit u gjetën të hedhura 350 fishekë luftarakë, lëndë

narkotike kanabis sativa dhe kubikë me fara kanabis, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale. Në përfundim të veprimeve u referuan materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë për shtetasin B.L.L., me detyrë kryeplak i fshatit Vasjar, Bashkia Memaliaj, për "Shpërdorim detyrë".



Zbardhet skema e abuzimit, përfundon në pranga edhe ndërtuesi Dritan Llanaj

# Skandali i tjetërsimit të pronës së Spitalit Ushtarak, prangosen dy pronarët dhe ndërtuesi Kadri Pazari dhe Arben Çaçi falsifikuan vendimin që iu njihte pronësinë e truallit, por jo kthimin

Klodiana Lala

Një ndërtues me probeme të hershme me drejtësinë dhe dy pasardhës të familjes së njohur tiranase, Pazzari, u ndaluan me urdhër të Prokurorisë së Tiranës, pas dyshimeve për pastrim parash, lidhur me skandalin e tjetërsimit të pronave të Spitalit Ushtarak. Hetimet kanë zbuluar se Kadri Pazari dhe Arben Çaçi kanë mundur të falsifikojnë vendimin nr.232 të vitit 2000 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i cili në fakt iu kishte njohur trashëgimtarëve të familjes Pazzari pronësinë mbi truallin në fjalë, por jo kthimin e tyre. Referuar vendimit origjinal, pronarëve u njihej e drejta e parablerjes se objektit të spitalit ushtarak, kur ai të privatizohej. Hetimet nxorën në dritë faktin se të dyshuarit kanë mundur të falsifikojnë vendimin që bën fjalë për truallin me sipërfaqe 21.000 metra katrorë brenda territorit të Spitalit Ushtarak, në të cilin kanë ndërhyrë duke i fshirë fjalisë një pjesë: "i kthehet z. Sheh Ali Pazzari pronësia mbi këtë truall, kur spitali të privatizohet" duke lënë vetëm fjalinë: "i kthehet z. Sheh Ali Pazzari pronësia mbi këtë truall". Skandali thellohet edhe më tej, përderisa Kadri Pazari e Arben Çaçi përmes mashtrimit kanë mundur të heqin nga dosja e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave vendimin e saktë të këtij institucioni dhe ta zëvendësojnë atë me dokumentin e falsifikuar. Më pas me ndihmën e zyrtarëve hipotekës, dyshohet se përmes rryshfetit, trashëgimtarët e familjes së njohur e kanë regjistruar pronën në hipotekë. Ndërkohë, me qëllim zhdukjen e gjurmëve të tjetërsimit të pronështet, të përfutur me dokumente false, të dyshuarit Pazari



Ndërtuesi, Dritan Llanaj



Prokuroria e Tiranës

### FALSIFIKIMI

Hetimet nxorën në dritë faktin se të dyshuarit kanë mundur të falsifikojnë vendimin që bën fjalë për truallin me sipërfaqe 21.000 m<sup>2</sup> brenda territorit të Spitalit Ushtarak, në të cilin kanë ndërhyrë duke i fshirë fjalisë një pjesë: "i kthehet z. Sheh Ali Pazzari pronësia mbi këtë truall, kur spitali të privatizohet" duke lënë vetëm fjalinë: "i kthehet z. Sheh Ali Pazzari pronësia mbi këtë truall". Skandali thellohet edhe më tej, përderisa Kadri Pazari e Arben Çaçi përmes mashtrimit kanë mundur të heqin nga dosja e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave vendimin e saktë të këtij institucioni dhe ta zëvendësojnë atë me dokumentin e falsifikuar.

ari e Çaçi vendosën të shkëmbenin sipërfaqen brenda territorit të spitalit me 600 metra katrorë tokë në pronësi të Dritan Llanajt me vendndodhje në Yzberisht. Mbi bazën e kësaj kontrate, Llanaj ka aplikuar në hipotekë duke

kërkuar të pajiset me dokument pronësie, por gjatë procesit zyrtarë të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme kanë konstatuar se prona që ai pretendonte mbivendosej me pronë shtetërore. Skandali është kallë-

zuar edhe nga një tjetër trashëgimtar i familjes së njohur, i cili pretendonte se përmes një testamenti të falsifikuar që në vitin 1939, fakti i hetuar e provuar nga prokuroria, atij jo i vidhej prona. Ai ka informuar hetuesit se po

përdorej një vendim i falsifikuar sikur trashëgimtarëve të Ali Pazarit iu është kthyer prona e Spitalit Ushtarak në një kohë që prona vetëm u është njohur si e tillë. Më tej, ai ka shpjeguar se mbi këtë pronë të përfutur përmes dokumenteve të falsifikuara është marrë dhe leje ndërtimi, duke u cenuar rëndë intereset e shtetit, por edhe të vetë atij, që nuk kishte përfutur asgjë nga prona e trashëguar. Hetimet e prokurorit Ervin Karanxha flasin për një skemë të pastër pastrimi parash nga tre të dyshuarit, të cilët kanë vepruar në bashkëpunim me njëri-tjetrin.

### SHKURT

#### Futet për të vjedhur, prangosen 23-vjeçari

**LEZHË** - Policia e Lezhës ka vënë në pranga një 23-vjeçar, pasi ka tentuar të grabisë një banesë. Mësohet se i riou D.K. në orët e para të mëngjesit të djeshëm ka tentuar t'i vjedhë banesën shtetasit Gj.K., banues në Lezhë, duke hyrë nga dritarja, por është konstatuar nga i zoti i banesës, i cili ka njoftuar menjëherë policinë. Falë reagimit të bluve u bë i mundur arrestimi i 23-vjeçarit në një prej dhomave të banesës së shtetasit Gj.K., ku gjatë kontrollit fizik, policia i gjeti një thikë. Materialet i kaluan Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë për veprat penale "Vjedhja" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta".

#### Aksidenti me vdekje, policia kap shkaktrin

**ELBASAN** - Policia e Elbasanit ka arrestuar një 27-vjeçar, i cili akuzohet si shkaktrin i aksidentit të ndodhur dy ditë më parë në aksin Pegin-Rrogoshinë, ku mbeti e vdekur një grua. Sipas policisë, i riou F.H., duke drejtuar mjetin tip "Toyota" është përplasur me një mjet tjetër dhe si pasojë ka gjetur vdekjen 65-vjeçarja F.B., banuese në Korçë, si dhe janë dëmtuar dhe dy të tjerë. Materialet hetimore i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan për veprat penale "Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor".

#### 55-vjeçari i zhdukur gjendet i mbytur në liqen

**LIBRAZHD** - Një ngjarje e rëndë është shënuar në Librazhd, ku një 55-vjeçar i zhdukur prej 20 ditësh është gjetur i mbytur në liqen. Gazetari Fatmir Popja raporton për "Gazeta Shqiptare" se në liqenin e fshatit Fushë-Stud, Librazhd është gjetur i mbytur shtetasi I. Lala, 55-vjeç. Pas njoftimit nga banorët, e vendl ka shkruar policia, e cila ka identifikuar dhe viktimën.

### I kërkuar nga Italia për trafik droge, arrestohet 29-vjeçari

**DURRËS** - Policia e Durrësit ka prangosur një 29-vjeçar të kërkuar nga Italia për trafik droge. Të premtën blutë bënë arrestimin e përkohshëm, me qëllim ekstradimit, të shtetasit Klejdi Abdyl, lindur në Tiranë dhe banues në Durrës. 29-vjeçari është shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi Gjykata e Peskarës në Itali ka lëshuar urdhër arresti për kryerjen e veprës penale "Trafikim i narkotikëve". Materialet procedurale u dërguan për veprime të mëtejshme në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.

## Vdekja e të dënuarit në Bëncë, Berisha: Tjetër vrasje shtetërore në burgjet e Kakistokracisë

**TIRANË** - Ish-kryeministri Sali Berisha ka reaguar përmes një postimi në "Facebook" lidhur me vdekjen e një të burgosuri, i cili pak ditë më parë ndërroi jetë në burgun e Bëncës në Tepelenë. "Një vrasje tjetër shtetërore në burgjet skëterre e regjimit të Kakistokracisë", - shkruan Berisha, ndërsa shprehet se akuzon narkoshtetin për vrasjen e tij, sepse vetëm në një narkoshtet dhe askund tjetër në botë mund të ndodhë që qytetari mbahet 3 vjet në burg për 13 gr hashash. "Akuzoj narkoshtetin për vrasjen e tij, sepse vetëm në një narkoshtet dhe askund tjetër në botë mund të ndodhë që qytetari mbahet 3 vjet në



burg për 13 gr hashash, ndërkohë kur nipi i diktatorit Enver Hoxha, Hitlerit shqiptar të pasluftës del nga burgu për tre vjet, ndonëse anëtar kryesor së bashku me Olsi Ramën i grupit të Xibrakës, grupit që dispononte fabrikën më të madhe të kokainës në Ball-

kan, ose lirohet brenda dy viteve megatrafikanti i magazinës së paku 13-24 tonelata kanabis në rrethin e Përmetit. Vetëm në shtetin e trafikantëve, gangsterëve, horrave mund të ndodhë kjo", - shkruan Berisha. Në vijim ai apelon institucionet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të ndërmarrin me urgjencë një inspektim në të gjitha institucionet e vuajtjes së dënimit në Shqipëri. "Me këtë rast i bëj thirrje Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor, Degradues pranë Këshillit të Europës, Komitetit Kundër Torturës të OKB, institucioneve të tjera ndërkombëtare të të

drejtave të njeriut të ndërmarrin me urgjencë një inspektim në të gjitha institucionet e vuajtjes së dënimit në Shqipëri, të njihen me kushtet, torturat fizike dhe psiqike çnjerëzore, mesjetare që ushtrohen ndaj të burgosurve, personelit i përbërë nga banditë me uniformë, trafikantë, delinkuentë, sadistë të narkoshtetit të instaluar Ftj këto institucione të konsiderojnë aplikimin e neneve ndëshkuese ndaj narkoshtetit shqiptar për qëndrimin kriminal ndaj personave që vuajnë dënimin apo janë në paraburgim në institucionet e vuajtjes së dënimit në Shqipëri", shkruan më tej Berisha.

Operacioni i koduar "Kompleksi", prangoset edhe i riu që strehoi 33-vjeçarin

# RENEA mësyt te "Komuna e Parisit", arrestohet anëtari i grupit kriminal

*Barush Bregu, i dënuar me 4 vjet burg në mungesë për kultivim droge, u kap në një banesë me qira*

TIRANË

Një 33-vjeçar nga Shkodra, i konsideruar si person me rrezikshmëri të lartë shoqërore u arrestua mesditën e djeshme të "Komuna e Parisit" në Tiranë gjatë një operacioni të forcave speciale RENEA në bashkëpunim me policinë e kryeqytetit dhe atë të qytetit verior. Bëhet fjalë për Barush Bregun, anëtar i një grupi kriminal në Shkodër, i shpallur në kërkim dhe i dënuar me 4 vite burg në mungesë për kultivim droge. Gjithashtu, gjatë operacionit të djeshëm i koduar "Kompleksi" përfundoi në pranga dhe 21-vjeçari Bajram Çekorja nga Shkodra, i akuzuar për veprën penale "Përkrahje e autoritetit të krim-



it". Burime zyrtare nga policia dje bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se operacioni u zhvillua në lagjen "Komuna e Parisit", ku në një banesë të marrë me qira u kap dhe u arrestua shtetasi i shpallur në

kërkim Barush Bregu, lindur në Shkodër. Sipas bluve, ky shtetas është i dënuar me 4 vite burg për kultivim të bimëve narkotike, kryer në bashkëpunim, në vitin 2016, si dhe me masë sigurie "Ar-

rest në burg", për armëmbajtje pa leje, pasi në shtator të vitit 2018, gjatë një operacioni të zhvilluar nga policia, në banesën e këtij shtetasi u gjet një armë zjarri kallashnikov dhe municion luftarak. Gjithashtu, mësohet se 33-vjeçari është i skeduar si pjesëtar i një grupi kriminal dhe është i dyshuar edhe si autor për ngjarje të tjera të rënda kriminale të ndodhura në qarkun Shkodër më parë, si dhe autor i dyshuar për "Trafikim të lëndëve narkotike". Po gjatë operacionit u arrestua në flagrancë edhe i riu Çekorja për përkrahje të autorit, pasi e ndihmoi të fshihet në Tiranë. Pas arrestimit në Tiranë të Bregut dhe shokut të tij, ata janë transportuar në qytetin e Shkodrës

## Me 1 mln euro drogë në makinë, pranga shqiptarit në Itali

ITALI - Një shqiptar dhe një italian janë arrestuar për veprën penale të trafikut të drogës. Mediat italiane raportojnë se autoritetet gjetën një sasi droge prej 100 kg, sasi të cilën dy të arrestuarit e kishin futur në makinën e tyre. "La Stampa" shkruan se sapo pikasën policinë, italiani dhe shqiptari tentuan të largoheshin me shpejtësi, por policia vijoi aksionin dhe më pas i prangosi ata përballë shtëpisë, ku jetonte 38-vjeçari nga Shqipëria. Sasia e lëndës narkotike ishte fshehur në sediljet e pasme të makinës, ndërsa dy trafikantët e kishin e paketuar drogën në thasë prej najloni me ngjyrë të kuqe. Nga të dhënat e para thuhet se nëse sasia e lëndës narkotike do shitej në treg me pakicë, ajo do kapte vlerën e 1 mln eurove. Pas arrestimit, policia italiane filloi kontrollin në bodrumin e shtëpisë ku jetonte shqiptari dhe prej aty u konfiskuan materiale, të cilat shërbenin për paketimin e lëndëve narkotike. Mediat italiane shkruajnë se origjina e drogës dyshohet të jetë jugu i Italisë ose Spanja. Ndërkohë, hetimet vijojnë për identifikimin dhe kapjen e personave të përfshirë si bashkëpunëtorë të shqiptarit dhe italianit, të cilët tashmë do të gjykojnë për veprën penale të trafikut të drogës.



dhe ditën e hënë do të dalin para gjykatës për t'u njohur me masën e sigurisë. Materialet do t'i kalojnë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprime të mëtejshme,

për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, shpërthyes dhe i municionit" dhe "Kultivimi i bimëve narkotike, e kryer në bashkëpunim".

**Tirana International Airport**  
Nënë Tereza

**TENDER NOTIFICATION**

**PEST MONITORING AND CONTROL FOR PREMISES (3D SERVICE)**  
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k (TIA) is requesting offers for pest monitoring and control for premises (3D Service).

TIA is looking to contract a company to undertake these services that will consist in general terms of: Pest monitoring and control service for disinfection, disinsection and deratization (3D) service and to maintaining a good level of hygiene, very good sanitary conditions, healthy and clean environment, safe operational premises, in order to prevent as well the spread of the infection or contamination and any animal hazard within TIA premises.

To participate in this process interested parties will need to submit their interest for participation by e-mail, to all below e-mail address, until 16 May 2019.

Upon receipt of the e-mail, TIA will send to the respective company a Confidentiality Commitment form.

The interested company will need to send the signed and stamped Confidentiality Commitment form, by e-mail, at all the e-mail address below, and only then they will receive all the necessary forms and instructions for participating in this tender.

The set of tender documents will be delivered free of charge, via e-mail.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked

"PEST MONITORING AND CONTROL FOR PREMISES (3D SERVICE)"  
The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k**  
Administration Building  
Rinas, Tirana  
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 17 May 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:  
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK  
Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania.  
Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545  
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com

**AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.**  
**LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,**  
**ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.**

**MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ**  
**CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET**

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET  
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR  
QR CODE APPLE DHE ANDROID



## SHFAQJA

## "ENGJËJT E AMERIKËS"

## Për lirinë, vetminë dhe të drejtën për të jetuar

Fatmira Nikolli

Skena të rënda? Secili i jep leximin e vet një veprë. Kjo ishte një shfaqje e mendimit më shumë se e veprimit. Me një skenografi minimaliste që nxirrte më shumë në pah lojën dhe tekstin, publiku si bartës i saj, mori me vete shijen e vetmisë së pafundme, komplekseve njerëzore dhe dështimin e sistemeve për të ndërtuar shoqëri, ku individi është i pari. Njerëzit vdesin të vetmuar e jetojnë të vetmuar. Njerëzit u ikin të gjithëve duke dashur t'i ikin së pari vetes, përballjes me imazhin e tyre në pasqyrë dhe nevojën për të qenë të pranuar në shoqëri. Njerëzit i ikin ndërgjegjes, që vjen si vegim në formën e një engjëlli, ose si makth në atë të një fantazme. Një shfaqje që zgjat disa orë në SHBA ku ka korrur sukses, në Tiranë i kalon 2 orët duke lënë pas pezmin e mesazheve që do të japë. Gjen gjithësesi linja ngjashmërie mes engjëjve shqiptarë dhe



*Shfaqja e Teatrit Kombëtar në javën e dytë, premiera që prek temat e homoseksualizmit e AIDS*

Ndërsa salla e 'Turbinës' nuk arrin të izolojë zërat e fëmijëve që luajnë jashtë në oborr, jashtë skenës dy çifte, një hetero dhe një homoseksual debatojnë me tone të ashpër.

Perdja ikën. Shfaqja zhvendoset në skenë. A do kemi çlirim prej së shkuarës? Kjo është pyetja që jehon në sallë. Një flamur i kuq me drapër, çekan e yll

shihen në një skenë bosh, ku feks e kuqja. Flitet për kapitalizëm surrogat. "Tregomëmi fjalët që do sjellin ndryshimin në botë, ose mos hapni gojë". - thotë figura e pidentifikueshme, e mbuluar me cohë të kuqe. Pas saj, një engjëlli të errët i ndriçojnë vetëm krahët. Ajo që nis si një mesazh politik mbi dështimin e kapitalizmit çka sfondi komunist

e bën më të sipërfaqshëm, vijon me atë që që shqetësimi i Amerikës në vitet 1980, sëmundja e AIDS dhe fshehja e saj. Shfaqja ka skena erotike mes dy personave të të njëjtit seks, por kjo vjen pothuaj krejt natyrshëm, pa lënë vend për komente. Vetë skena është në funksion të idesë që përvijon të tërën. Krejt larg shfaqjeve klasike, regjisorit ka konceptuar një shfaqje me element modernë në qëndrimin e aktorëve në skenë, në këndet që krijojnë ambiente të ndryshme dhe kjo nis që me punën e bërë me tekstin e ndërthurjen e linjave. Nga mesazhet politike, te dështimi i politikave. Nga e drejta për të qenë të barabartë, te mundësia për të qenë më i barabartë. Nga e drejta për të jetuar, te pasuria e shantazi që blen të drejtën për të jetuar më gjatë. Marrëdhëniet seksuale nuk del të jenë më shumë se një ikje nga vetja. Gjen në të personazhet e çdo shoqërie: një burrë të fuqishëm që ka "ndryshuar" rrjedhën e gjërave, jo duke zbatuar ligjin, por duke e përdorur atë, sepse për të rëndësi ka të mbarosh punë, jo të jesh i mirë. Roy (Helidon Fino) pyet "a do të jesh njeriu që i nënshtrohet ligjit, apo

njeriu që bën ligjin"? Ai personifikon njeriun e fuqishëm, që ka shkelur këdo dhe çfarëdo gjatë gjithë jetës për të arritur qëllimet e veta, duke fshehur prirjet e veta seksuale. Skenat e degradimit të tij vijnë natyrshëm prej Finos, që ka veshur në lekurë rolin e Roit. Në të njëjtën shkallë qëndron infermieri (Belize), interpretuar nga Indrit Çobani. Në galerinë e personazheve që sjell vepra, Çobani ka arritur të përcjellë natyrshëm si të ishte jeta e tij infermierin e zakonshëm, gay me ngjyrë. Ecja, qëndrimi, zëri, tonaliteti i japin atij një prej roleve më të veçan-

ta që ka bërë. Jo prej teatrit. Është Çobani që ka punuar me veten, duke veshur psikologjinë e personazhit për ta përcjellë pa asnjë të metë. Mes skenave që ngjajnë herë si rite adhurimi e herë si rite satanike të sekteve amerikane, mesazhet profetike i shtojnë shfaqjes dualitetin e një jermi, duke na kujtuar se e kemi braktisur dhe na ka braktisur e në këtë braktisje të madhe nuk kemi humbur vetëm hyjnoren e njerëzoren, por edhe veten. Kjo është humbja e madhe.

Ina Gjonci sjell një tjetër portret gruaje dhe Laert Vasili një tjetër portret homoseksuali, që bashkë Donald Shehuan, të dyzuarin e paqartë e me Gentë Deçkën që mban rolin kryesor plotësojnë galerinë e "Engjëjve të Amerikës" bashkë me Dr Henry (Vasjan lami). Ndërsa Luli Bitri sjell engjëllin, Luiza Xhuvani vjen me rolin e një nëne, një gruaje të zakonshme, që nuk pranon dot homoseksualitetin e të birit. Cilat janë mesazhet? Secili merr mesazhet e tij, duke lënë mënjane çfarë nuk i shkon për shtat. Shfaqja që prek temën e raporteve seksuale të të njëjtit seks i lë mënjane gratë, duke ndërthurur në skenë një jetë burrash homoseksualë që vuajnë, japin, nuk duhen, lihen vetëm, vdesin vetëm, duke qenë gjithnjë të palumtur e të paplotë. Gratë ose nuk janë, ose janë në funksion të burrave. Sepse burrat "krijojnë" personazhet, historitë dhe emrat.



## SHFAQJA

Shfaqja nis me drita ndezur. Regjisorit Ken Kumburo ulet në radhën e dytë.

**SHPLLALJE ANKANDI**

Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me përmbarrues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 30.05.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II-të për shpëtim e pasurive të paluajtshme në pronësi të Z.Shpëtim Barjam Boçi.


- Truall me sipërfaqe 2863 m<sup>2</sup>. Nr. pasurie 88/16, Zona Kadastrale nr.2007, Volumni 9, Faqe 107 ndodhur në Jorgucat Gjrokastrë, me vlerë fillestare në ankan 46098.4 (Dyzet e tetë mijë e nëntëdhjetë e tetë pikë katër) EURO
- Truall me sipërfaqe 2317 m<sup>2</sup>. Nr. pasurie 88/25, Zona Kadastrale nr.2007, Volumni 9, Faqe 121 ndodhur në Jorgucat Gjrokastrë, me vlerë fillestare në ankan 38'925.6 (Tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e njëzet e pesë pikë gjashtë) EURO
- Truall me sipërfaqe 790 m<sup>2</sup>. Nr. pasurie 88/23, Zona Kadastrale nr.2007, Volumni 9, Faqe 119 ndodhur në Jorgucat Gjrokastrë, me vlerë fillestare në ankan 13'272 (Trembëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) EURO
- Truall me sipërfaqe 780 m<sup>2</sup>. Nr. pasurie 88/20, Zona Kadastrale nr.2007, Volumni 9, Faqe 111 ndodhur në Jorgucat Gjrokastrë, me vlerë fillestare në ankan 13'104 (Trembëdhjetë mijë e nëntëqind e katër) EURO
- Truall me sipërfaqe 1750 m<sup>2</sup>. Nr. pasurie 88/18, Zona Kadastrale nr.2007, Volumni 9, Faqe 109 ndodhur në Jorgucat Gjrokastrë, me vlerë fillestare në ankan 29'400 (Njëzet e nëntë mijë e katërqind) EURO

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

E DIEL

5 Maj

2019



# SKËNDERBEU i Kristo Frashërit

NGA GJERGJ FRASHËRI

**E**shtë domethënëse dedikimi që historiani akademik Kristo Frashëri i ka bërë veprës së tij në fjalët e mëposht me: "Nuk është i saktë pohimi i disa historianëve skeptikë, se Skënderbeu e ngriti në piedestalin e historisë shekullore -jo vepra e tij, e cila, sipas tyre, ka qenë modeste, por Marin Barleti me stilin e vet elegant, klasik dhe humanist. Në këtë punim provohet e kundërta. Është Skënderbeu ai, që me madhësinë e veprës së tij frymëzoi bashkatdhetarin e vet, Barletin, të shkruante për atë veprën e pavdekshme".

Për herë të parë monografia e historianit akademik Prof. Dr. Kristo Frashëri me titull

"Skënderbeu - jeta dhe vepra (1405-1468)" doli në dritë në vitin 2002, nën kujdesin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Por atëherë, vepra e tij nuk arriti të botohej e plotë. Sepse autori e pat konceptuar dhe përgatitur monografinë e tij të ideuar dhe të lidhur bashkë edhe me nëntë vëllime me burime dokumentare, si një veper të vetme dhjetë vëllimshme, si një trup i pandashëm shkencor, si një tren me lokomotivën dhe nëntë vagonat e tij (ose e thënë në mënyrë popullore, si "killocka me nëntë zogjtë e saj"). Nëntë vëllimet me burime dokumentare (vëllimi II deri vëllimi X) që shoqërojnë Monografinë, janë dokumente të shek 15, bashkëkohëse të Heroit, të cilat fillojnë me kohën e Gjon Kastriotit dhe mbarojnë me vdekjen e Skënderbeut.

→ Vijnë në faqen 14

## Ernest Hemingway Si fillova të shkruaj!

**I**a tregova draftin e parë Nathan Asch, një romancier, që shoqërohesha atëherë -ndërsa ai me një theks të fortë më shqiptoi prerë: "Hem, çfarë doni të thoni me këtë që keni shkruar një roman? Një roman hëh. Hëm Ju keni bërë një libbërr udhëtimi". Unë s'u dekurajova nga Nathani dhe e rishkrova librin, duke e mbajtur në dorë gjatë udhëtimit (që ishte pjesa e një udhëtimi peshkimi dhe Pamplona) në Schruns në Vorarlberg deri në Hotel Taube. Ndërsa për sa i përket historive që përmendni dhe që unë i shkrova në po të njëjtën ditë në Madrid më 16 maj, përkoji me borën që binte në fushë-luftimin e San Isidoro. Të parën që shkrova isha "Vrasësit" që isha përpjekur ta realizoja edhe më parë por kisha dështuar. Një moment gjatë drekës u futa në krevat të rrija ngrohtë dhe shkrova "Sot është e premte". Kisha aq shumë lëng dhe po më dukej se isha duke u çmendur, sepse kisha gati plot edhe gjashtë subjekte për të shkruar. Kështuqë u veshja dhe eca drejt Fornos, një kafe e vjetër e toreadorëve dhe pasi gjerba kafën u ktheva dhe shkrova "Dhjetë indianët". Kjo më mërzi dhe piva shumë konjak dhe vetëm pastaj më zuri gjumi. Kisha harruar të haja dhe një nga kamerierët më solli sipër bacalao dhe një biftek të vogël, shoqëruar me patate të skuqura dhe një shishe me Valdepenas.

**Në këtë numër: GEORGE PLIMPTON, SRDAN SRDIÇ, GJERGJ FRASHËRI, NIKOLIN GURAKUQI, ALFONS ZENELAJ ETJ.**

A

ARGUMENT

Më 23 prill 2019 në një nga sallat e Pallatit të Kongreseve në Tiranë u bë promovimi i kolanës prej 10 vëllimesh mbi "Jetën dhe veprën e Gjergj Kastriotit Skënderbeut" të historianit Kristo Frashëri. Seria përbëhet nga monografia (vëllimi I) dhe nëntë vëllime me dokumente të shek. 15, të kohës së heroit (vëllimi II deri X). Në këtë promovim historianit Kristo Frashëri iu dha dekorata e lartë "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nga Presidenti i Republikës. Më poshtë japim një vështrim mbi përmbajtjen e kësaj vepre cilësore dhe voluminoze të historianit tonë të mirënjohur. Nëntë vëllimet me burime dokumentare (vëllimi II deri vëllimi X) që shoqërojnë monografinë janë dokumente të shek. 15, bashkëkohëse të heroit, të cilat fillojnë me kohën e Gjon Kastriotit dhe mbarojnë me vdekjen e Skënderbeut.

# "Skënderbeu" i Kristo Frashërit

NGA GJERGJ KRISTO FRASHËRI\*

Pse një botim kaq voluminoz? E thënë ndryshe, pse autori e pa të nevojshme shoqërimin e monografisë me botimin në vëllime të posaçme edhe të burimeve dokumentare historike? Përgjigjen e ka dhënë vetë autori, i cili nënvizon: "Për ta shpëtuar Heroin dhe luftën epike të shek.15 nga kritikët që u bëheshin dy biografeve kryesorë korifjen të tij, Barletit si panegjirik dhe Biemmit si falsifikator. qysh herë m'ë lindi pyetja, nëse mund të trajtohej një histori e Skënderbeut dhe e epopesë së shek.15 duke u mbështetur vetëm në burimet dokumentare bashkëkohore, pa shfrytëzuar veprat e dy biografeve të diskutueshëm të lartpërmendur. Për të realizuar këtë detyrë u desh një kohë e gjatë. U bënë përpjekje për të grumbulluar gjithë materialin e mundshëm dokumentar të shek.15, pra burimet e pavarura nga veprat e Barletit dhe Biemmit. Materiali me burime dokumentare i grumbulluar deri sot, i sistemuar në origjinal dhe në përkthimin shqip, deri tani mbush nëntë vëllime. Ai përbëhet nga akte shqiptare dhe të huaja, perëndimore dhe lindore, të vjetra nga historianët të ndryshëm në arkivat e Venedikut, Raguzës, Romës, Napolit, Milanos, Barcelonës, Parisit, Ankarasë dhe Stambollit. Ky material, kryesisht kancelaresk, plotësohet me kronistët osmanë, ata bizantinë dhe italianë të shek.15. Ai pasurohet gjithashtu me shkrime memorialistike dhe me letërkëmbime të disa personaliteteve shqiptarë dhe të huaj të gjithë bashkëkohëtarë të Heroit".

1. Moria e këtyre burimeve historike dokumentare, me natyrë kancelareske, diplomatike, epistolare, kronikale në gjuhët latinisht, në italishten mesjetare, frëngjisht, spanjisht, osmanishte, në greqishten bizantine, sllavisht, në serbisht, deri në polonisht e gjermanisht, të dhëna në origjinal dhe të përkthyer në shqip, ndjekin kriterin tematik dhe janë radhitur në atë kronologjik. Autori ka sjellë aty, të gjitha burimet dokumentare që ka mundur të bjerë në kontakt, të periudhës prej lindjes së Skënderbeut deri kur ai vdiq. Janë përfshirë gjithashtu edhe disa kronika, të cilat ndoshta janë redaktuar në periudhat pas vdekjes së Skënderbeut, por autorët e tyre fillestarë janë bashkëkohës të Heroit, pra, nuk janë ndikuar nga Marin Barleti. Historiani akademik Frashëri nuk i ka lejuar vetes të bëjë përzgjedhje dokumentesh që flasin për temën në



Kristo Frashëri, 2000

fjalë, as të mënjanojë apo të seleksionojë ndonjërin prej tyre duke e paragjykuar vërtetësinë apo autenticitetin e brendisë së dokumentit përmes interpretimit politik, fetar, nacional, apo çfarëdo tjetër interesi. Secilën prej tyre ai e ka sjellë në formën origjinale arkivore, në të shumtën rasteve me përkthimin e plotë në gjuhën shqipe, pak herë i përkthyer me shkurtime (duke i kapërcyer fragmentet, që nuk bëjnë fjalë për temën), ndërsa për pak syresh ka mjaftuar vetëm një përmblidhje (regest) në gjuhën shqipe. Pjesa më e madhe e dokumenteve botohen në përkthimin shqip për herë të parë. Për çdo dokument është shënuar burimi ku ndodhet.

Ribotimi i sotëm me plotësim dhe redaktim i monografisë (2018) dhe i pajisur kësaj radhe me vargun prej nëntë vëllimesh të burimeve historike dokumentare që kemi në dorë, gjithsej pra dhjetë vëllime, del në dritën e aktiviteteve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me rastin e Vitit Jubilar të 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut (1468-2018). Përsëri ishte përkujdesja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, që vepra e plotë e lënë nga historiani Kristo Frashëri mbi veprën dhe jetën e Skënderbeut (vëllimi I),

## Me gjuhën e Kristos

"Për ta shpëtuar heroin dhe luftën epike të shek.15 nga kritikët që u bëheshin dy biografeve kryesorë korifjen të tij, Barletit si panegjirik dhe Biemmit si falsifikator, qysh herë m'ë lindi pyetja, nëse mund të trajtohej një histori e Skënderbeut dhe e epopesë së shek.15 duke u mbështetur vetëm në burimet dokumentare bashkëkohore, pa shfrytëzuar veprat e dy biografeve të diskutueshëm të lartpërmendur. Për të realizuar këtë detyrë u desh një kohë e gjatë. U bënë përpjekje për të grumbulluar gjithë materialin e mundshëm dokumentar të shek.15, pra burimet e pavarura nga veprat e Barletit dhe Biemmit. Materiali me burime dokumentare i grumbulluar deri sot, i sistemuar në origjinal dhe në përkthimin shqip, deri tani mbush nëntë vëllime. Ai përbëhet nga akte shqiptare dhe të huaja, perëndimore dhe lindore, të vjetra nga historianët të ndryshëm në arkivat e Venedikut, Raguzës, Romës, Napolit, Milanos, Barcelonës, Parisit, Ankarasë dhe Stambollit. Ky material, kryesisht kancelaresk, plotësohet me kronistët osmanë, ata bizantinë dhe italianë të shek.15. Ai pasurohet gjithashtu me shkrime memorialistike dhe me letërkëmbime të disa personaliteteve shqiptarë dhe të huaja, të gjithë bashkëkohës të heroit".

e shoqëruar ajo me serinë prej nëntë vëllimesh me titull të përbashkët "Lufta shqiptare-osmane në shek.15. Burime dokumentare", të gjente e plotë dritën e botimit. Të dhjetë vëllimet janë renditur në këtë mënyrë:

Vëll. 1 Monografia "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu. Jeta dhe vepra (1405-1468)"

Vëll. 2 Burime Dokumentare Shqiptare: 91 akte kancelareske+2 burime tregimtare.

Vëll. 3 Burime Kancelareske Perëndimore 1407-1442: 70 dokumente.

Vëll. 4 Burime Kancelareske Perëndimore 1443-1450: 62 dokumente.

Vëll. 5 Burime Kancelareske Perëndimore 1451-1456: 126 dokumente.

Vëll. 6 Burime Kancelareske Perëndimore 1457 - 1459: 90 dokumente.

Vëll. 7 Burime Kancelareske Perëndimore 1460 - 1464: 182 dokumente.

Vëll. 8 Burime kancelareske perëndimore 1464-1497: 163 dokumente+1 shtojcë

Vëll. 9 Burime Osmane: 21 dokumente

Vëll. 10 Burime tregimtare euro bizantine shek 15: 21 dokumente

2. Së pari duhet nënvizuar, se vetë autori i pati bërë gjatë viteve 2002-2016, disa përpunime monografisë së tij të botuar në vitin 2002, të tilla si shtesën e parathënies duke e aktualizuar me reagimet shkencore dhe publicistike që pasuan botimin e atëherëshëm të saj; po ashtu në shtimin e dy kapitujve (Kreu III me titull "Bujarët mesjetarë shqiptarë" dhe Kreun VI me titullin "Çështja e dorëzimit peng të Skënderbeut"). Nga ana jonë janë bërë në monografi disa shtesa dhe pak plotësime në anën tekstore dhe ilustruese të saj, të cilat ishin lënë prej autorit në formë shënimesh anësore përmbi dorëshkrimet e tij, por edhe shprehur gjatë bisedave dhe diskutimeve të ngushta në tavolinën e punës së tij, të cilat i pata mbajtur shënim herëpashere; edhe për arsyen, pasi im Atë në vitet e fundit, siç dihet, e pat humbur shikimin. Këto plotësime dhe shtesa jam përpjekur t'i pasqyroj në rolin e redaktorit shkencor. Gjithashtu nënvizojmë, se dokumentacioni i paraqitur në nëntë vëllimet shoqëruese të monografisë, është mblodhur, vlerësuar, radhitur dhe përgatitur për botim, si koncept dhe si grupim në kriterin kronologjik, nga vetë akademikur Frashëri, rezultat i një pune shumëdekadëshe mbi temën

skënderbegiane, e cila është e njohur dhe e prekshe nga kushdo, mjafton t'i hedhë një sy bibliografisë së tij 70 vjeçare (shih faqen në: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Biblioteka Shkencore, Katalogu Elektronik, Bibliografite shkencore online: Bibliografia e akademikur Kristo Frashëri, ose: eëë.al.cobiss.net/bibliorafije/Y20181114063548-00728.html).

Një pjesë e mirë e burimeve dokumentare (letrat, kronikat, etj.) janë sjellë me tekst të plotë në origjinal dhe të përkthyer plotësisht në gjuhën shqipe. Në disa raste, dokumenti i është sjellë këtu lexuesit në origjinal të plotë, por përkthyer me shkurtime. Në një pjesë tjetër të tyre janë lënë mënjana pasazhe apo paragrafë nga dokumenti origjinal, të cilat nuk kanë lidhje me tematikën. Nga dora e akademikur është bërë edhe klasifikimi dhe titullimi i tërë dokumentacionit të ndarë në nëntë vëllime, i hartuar prej tij në formë drafti dhe i lënë në gjendjen e dosjeve me dorëshkrime. Ndërhyra jonë redaksionale në dosjet me dorëshkrime është kufizuar vetëm në përpunimin e materialit të mblodhur dhe të titulluar (rubrikuar), në ndonjë rast të paqenësishëm por të rekomanduar prej tij.

3. Në mungesë të autorit, udhëheqja dhe redaktimi shkencor i veprës dhjetë vëllimesh që kemi tashmë të botuar, është kryer prej meje. Ndihmesë me vërejtjet e saj në fazën e parë të redaktimit për disa burime dokumentare ka dhënë edhe historiania Prof. Dr. Zana Frashëri-Lito. Ndërsa për realizimin e të gjithë spekitrit tekniko-shkencor të vargut dhjetë libror, mbi veprën dhe jetën e Gjergj Kastriotit Skënderbeu dhe epokës së tij, duhet sjellë këtu edhe kontributi i disa punonjësve të "Qendrës Frashëri" Tiranë. Punë tepër e cmuar e këmbëngulëse është bërë nga Redaksia Teknike nën drejtimin e Dr. Antonia Schütz-Frashëri (Fondacioni "Qendra Frashëri"), në organizimin, realizimin dhe përpunimin tekniko-shkencor të monografisë dhe të nëntë vëllimeve me dokumente, të qëntim identifikues dhe radhimin në kompjuter një për një të dokumenteve, të redaktimit të bibliografisë dhe të referencave, të faqosjes (lay-out) së tyre, përpunimit grafik të tekstit, të ilustrimeve dhe kopertinave.

Një pjesë e madhe e dokumenteve origjinale në gjuhën latine, osmane, bizantine, etj. dhe përkthimi i tyre në gjuhën shqipe është marrë direkt nga autorët profesionistë që i kanë hulumtuar dhe

A

ARGUMENT

NGA BEN ANDONI

Këmbëngulja sesi po flitet për prishjen e Godinës së Teatrit Kombëtar nga kryeministri Rama dhe nga zyrtarët e tjerë tregon se godina, që mori jetë në Luftën e Dytë Botërore, i ka ditët e numëruara. Jo sepse pak ditë më parë u hoqën gërmat, që në mënyrë simbolike e shënjonin ende godinën e aq projekteve kulturore të cilat bënë historinë të teatrit, por nga heshtja e madhe që rrethon të gjithë problematikën e saj. Aleanca për Teatrin vazhdon kundërshtinë e saj dhe mbetet një nga lëvizjet më jetëgjata në vazhden e protestave në vend, porse duket dhe ata në këtë stad janë të lodhur nga mungesa e një dialogu të vërtetë me qeveritarët, por edhe bindjen e tyre për të vazhduar. Në fakt, dialogu i iniciuar pak muaj më parë i ndau keq artistët por tregoi edhe problematikën tonë të madhe, e cila lidhet pikë së pari me honet e mëdha kulturore, por edhe përçarjen që kemi mbjellë ngado. Kjo e fundit merr jetë nga presioni e të gjitha mënyrave dhe që për jo çudi politika shqiptarë i ka kthyer në institucion.

Për fat të keq, paçka se bashkëpunimi me PPP-të quhet si një mundësi e mirë për zhvillim dhe për hir të së vërtetës ka ndihmuar e po realizohet në vende me kapitalizëm të zhvilluar, kur vjen puna tek ne, duket se mban pak erë. Kjo është parë në mungesën e transparencës, por edhe predispozitën e vërtetë për ta ndarë shqetësimin me komunitetet për ngritjen e tij. Specialistë mendojnë se zgjidhja mund të bëhet falë një transparence projekti, por edhe Ligjit të Koncesionit, por po ashtu këmbëngulet te transparenca: elementi që ndihmon zhvillimin, por edhe pastërtinë e qëllimit...

## A po merr udhë prishja e Teatrit?!

Ajo që të trishton është se nga Ministria e re e Kulturës pati një prononcim pozitiv lidhur me mosprishjen e tij, por që tashmë është lënë në mes, pasi ajo është pjesë e këtij Ekzekutivi, që sot ose nesër do ta prishë Godinën. Medoemos. Për fatin e vet duhet theksuar fakti që godina po përfiton prej kaosit në vend dhe gjendjes ku opozita ka bojkotuar pushtetin parlamentar duke kërkuar në rrugë mosbindjen civile dhe duke u përpjekur të ngjallë një revoltë kombëtare e cila ende nuk po merr jetë në formën e premtuar.

Shqiptarët të lodhur nga tranzicioni i stërgjertë, nga mënyra sesi bëhet politika në Shqipëri, por edhe nga makutëria e politikanëve në



një farë mënyre janë dorëzuar. Kjo sepse varfëria dhe mungesa e perspektivës të bën të jesh thjesht i zhveshur dhe nga shpirti dhe nga gjëra që kërkojnë angazhime të mëdha si ato që kërkon përkrahja e një kauze për teatrin. Ndoshta godina e kësaj të fundit nuk përmush shumë parametra, ndoshta është vërtetë si thuhet paçka se çdo gjë mund të restaurohet, porse na ka mësuar diçka se rrezimi i tij është një akt që pushtetarët mund ta bëjnë për çfarëdo godine thjesht për të arritur tjetërsimin e hapësirës, që në një të ardhme jo të largët do e mbjellin me kulla.

Për fat të keq, paçka se bashkëpunimi me PPP-të quhet si një mundësi e mirë për zhvillim dhe

për hir të së vërtetës ka ndihmuar e po realizohet në vende me kapitalizëm të zhvilluar, kur vjen puna tek ne, duket se mban pak era. Kjo është parë në mungesën e vazhdueshme të transparencës por edhe predispozitën e vërtetë për ta ndarë shqetësimin për ngritjen e tij. Specialistë mendojnë se zgjidhja mund të bëhet falë një transparence por edhe Ligjit të Koncesionit, por këmbëngulet te transparenca: elementi që ndihmon zhvillimin por edhe pastërtinë e qëllimit.

Prishja e teatrit duket shumë afër. Ajo do të ndodhë ndonjë moment natën, ose në ditët e ngrrohta kur njerëzit do mbyllin nëpër shëptë të mbarojnë ditën e tyre, porse një gjë duhet të kuptojnë politikanët: Nuk mund të sillësh në këtë mënyrë me pronat publike. Nuk mund të rrënosh një trashëgimi paçka sa modeste të mendohet ajo.

Kauza e teatrit do të mbahet mënd edhe për një fakt sesi një vullnet i bukur dhe i përqafuar nga një masë e madhe njerëzish nuk mund të respektohet por edhe nga fakti sesi interesi e mbyt dëshirën...dhe transparencën, duke e vrarë shpresën.

botuar ato më parë, si Fan Noli, Selami Pulaha, Koço Bozhori, etj., apo nga grupi i autorëve, përkthimet e të cilëve ndodhen në dorëshkrim apo të daktilografuara në Arkivat e institucioneve shtetërore, etj., kontribute të cilat janë treguar me korrektesë në serinë e dokumenteve. Gjithashtu, përkthime nga latinishtja në shqip që botohen këtu për herë të parë, janë akte të botuara prej J. Radonçit, të përkthyer në shqip nga Pashk Gjeçi, përkthime të cilat ndodhen në Arkivin e Institutit të Historisë Tiranë apo në Arkivin e Shtetit (ndërsa origjinale të tyre në dorëshkrim nga përkthyesi ndodhen të sistemuara dekada më parë në dosjet e historianit akademik Kristo Frashëri (pranë Arkivës së "Qendrës Frashëri" Tiranë); ndërsa ato sllavisht nga S. Lazri. Disa akte në latinisht janë përkthyer në shqip ose hartuar me tekst përmblidhës (regist) nga Mrs. Fatjon Balliu; ato nga italishtja mesjetare dhe frëngjishtja prej vetë autorit të veprës Prof. Dr. Kristo Frashëri; ato pak nga gjermanishtja prej Dr. Antonia Schütz-Frashëri, etj.

Së fundmi autori dëshiron të kujtojë, se koleksioni i mbledhur i burimeve dokumentare në këto vëllime, i vlerësuar i radhitur dhe i ndarë nën konceptin metodologjik, madje i grupuar edhe nën kriterin kronologjik, nuk është kurrësi i mjaftueshëm dhe aq më pak shterues, për ndriçimin dokumentar të jetës dhe të veprës së Gjergj Kastriotit Skënderbeut dhe luftës heroike të popullit shqiptar në shek. 15 nën udhëheqjen e tij. Ai është i sigurt, se dokumente të tjera do të zbulohen në të ardhmen, të cilat do t'u shtohen atyre tashmë të botuara për herë të parë në këtë format sh-



Kristo dhe Gjergj Frashëri (autorit)

kencor prej nëntë vëllimesh. Por ai beson se kjo bazë konceptuale dhe ky grupim tematiko-kronologjik i burimeve dokumentare të dhënës prej tij në këto nëntë vëllime, mund të jetë i qëndrueshëm për studimin sistematik shkencor të kësaj teme.

### Kristo Frashëri për veprën e tij

"Nuk është i saktë pohimi i disa historianëve skeptikë, se Skënderbeun e ngriti në pedestalin e historisë shekullore - jo vepra e tij, e cila, sipas tyre, ka qenë modeste, por Marin Barleti me stilin e vet elegant, klasik dhe humanist. Në këtë punim provohet e kundërta. Është Skënderbeu ai, që me madhësinë e veprës së tij frymëzoi bashkatdhetarin e vet, Barletin, të shkruante për atë veprën e pavdekshme".

manist që e ngriti Gjergj Kastriotin në pedestalin e historisë shekullore, por është madhështia e veprës së Skënderbeut që frymëzoi bashkatdhetarin e vet, të shkruante për atë veprën e pavdekshme - ashtu siç n'a frymëzojnë edhe në burimet dokumentare për njohjen e figurës së lartësuar të Renesancës Europiane, Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

4. Sikurse u tha, monografia që po ribotohet, bashku me nëntë vëllimet historike dokumentare janë përgatitur nga vetë autori. Autori u nda nga jeta më 31 Janar 2016 dhe mjerisht sot nuk ndodhet përpara veprës së tij të plotë të botuar, ta shohë ashtu siç e ëndërronte. Kristo Frashëri erdhi në jetë më 1920, tetë vjet pas Shpalljes së Pavarësisë dhe pikërisht në vitin e Kongresit të Lushnjës, atëherë kur, pas pesë shekuj nën Perandorinë Osmane, filloi të organizohej e të mëkëmbej shteti shqiptar i pavarur. Ai lindi në Stamboll në mjedisin e njërës prej familjeve të mirënjohura të Frashërlinjve, pjesëmarrëse në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe me pinjollë veprimtarë dhe sponsorues të Lidhjes së Prizrenit. Ai ishte djali i parë i atdhetarit dhe publicistit rilindas Anastas Josif Frashërit dhe nënës Evdhoksia Tole, gjithashtu edhe ajo prej një familjeje të njohur patriotike nga Ogri i Dangëllisë të Tiranës më 1924 me qeverinë e Nolit, ndërsa familja e tij bashkë me Kriston u riatdhesua në Tiranë më 1927. Në Tiranë, Kristo përfundoi Gjimnazin më 1939.

Në fëmijëri ai u rrit me preokupimin familjar të asaj kohe - "për të bërë Shqipërinë". Në vitet pas Shpalljes së Pavarësisë doli në plan

të parë detyra patriotike dhe mundësia reale, që historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve, aq e munguar deriatëherë prej shekujsh, të shkruhej nga vetë shqiptarët, ashtu siç kishin filluar t'a skiconin Rilindasit tanë. Doja të thoja, se nuk ishte rastësi, që ai qysh fëmijë u nxit duke u mbuluar me dashurinë atërore, që të zgjidhte profesionin e historianit për të kryer këtë detyrë, aq të domosdoshme për mbjetesën qytetare që kishte në ato dekada vendi ynë. Koha tregoi se përkushtimi për historinë u bë frymëzimi i jetës dhe puna e palodhur e tij.

Me gjithë vështirësitë politike që i nxorri jeta dhe realiteti i viteve '40 të shekullit të kaluar, në sajë të punës së tij këmbëngulëse përmes studimeve historike që paraqiti në fillimet e viteve '50 dhe me përkrahjen e historianit Aleks Buda, ia doli të rreshtojë në frontin e institucioneve shkencore të vendit për studimet historike. Nuk ka qenë vetëm një herë, që kam dëgjuar prej tim Eti në bisedat familjare të mbrëmjeve të vona, pengun e madh të tij - atë që i Ati i tij Anastasi, vdekur më 1958, nuk kishte arritur të shihte të botuar historinë e parë të plotë akademike të Shqipërisë në dy vëllime më 1959 dhe 1965, ku Kristo kishte shkruar si autor, pjesën e historisë mesjetare dhe të periudhës së Rilindjes Kombëtare. Madje nuk arriti t'i tregonte të Atit, as edhe të parën "Sintezë mbi Historinë e Shqipërisë" që botoi si autor i vetëm në tre gjuhë, më 1964.

Vijon

\* Udhëheqës dhe redaktor shkencor

Tiranë, Prill 2019

E

ESSE

*Eseja e fundit që përcjell artisti i njohur dhe akademiku kosovar shpreh jo thjesht zhgënjimin e një brezi që ka jetuar dekada të tërë histori, por metamorfozën e plotë të dhimbjes. Ajo nuk është më e lidhur me mospasjen e lirisë, por pikërisht me vrasjen e saj në kohën e shumë prituri të pavarësisë ... nga të panginjurat*

# SI ARRITEM TA VRASIM LIRINE

NGA REXHEP FERRI

1. Pse kam frikë.  
Erdha për diçka tjetër.  
Për të qenë vetvetja kam humbur shumë gjak.  
Tani ëndrrat le të fluturojnë.  
Gjithçka është e mundur.  
T'i mos u largo kur je afër, shpirtit i thashë.  
Unë do të mendoj edhe për nesër.  
S'mund ta fshih.  
Dëshiroj diçka që është në lëvizje.  
Që nuk merr e që s'jep pa ndryshuar ngapak.  
Ndoshta kam frikë nga jeta.  
Çfarë ndjesie është qetësia e saj.  
Për të një ditë lexova librin e pashkruar.  
Aty i gjeta fjalët që i kisha harruar.  
Gjatë rrugës, gurët kilometrikë të rrugës i luajta nga vendi.  
Dëshirova të isha larg.  
Dhe të isha afër.  
Atje ku s'ka asgjë për të fshehur dhe asgjë për të harruar.  
Për nesër, pa nesër, qitjani pikën.  
Fikën.  
Ka kush mendon për ne.  
Pa patriotë sojlinj nuk kemi të gjallë.  
Jeta qenka art.  
Dramë për teatër, për rrumpallë.  
Me njerëzit nga zjarri.  
Me njerëzit nga lumi.  
Kohën lërljani kohës ta kuptojë kohën.  
Nuk është hera e parë që njerëzit nuk e kuptojnë as kohën e as vetveten.  
Thonë se ka pasur flutura që janë sjellur rreth kandilit.  
Tani ku është shpirti i tyre është edhe ëndrra ime.

2. Nëse më pyetni si po më shkon dita, mos mendoni shumë.  
Ulem, pres  
Me një liri që ka probleme me gabime të veta nuk po di se çka të bëj.  
Minutë pas minute veten e gjej të humbur  
Për të qenë edhe më i qartë mbeta në shqetësime provokuese.  
Hapësira për vlera të humbura po na rritet.  
Nga dita në ditë.  
Shkallë-shkallë.  
Po zbrësim poshtë e më poshtë.  
Për sa i takon kohës urrejta është njëfarë frike banale.  
Mos të ishte e panjohura e jetës, as frika e as urrejtja nuk do të kishin kuptim.  
Me rëndësi është se ka kush mendon për ne.  
Nesër është edhe sot.  
Me heshtje kam shumëçka për të thënë.  
Deri të marifetet diplomatike as bota akademike nuk po di si dhe ku duhet të preket teli, ta qesë pikën.  
Betoveni ka shkruar një himn për gëzimin, por ky gëzim betovenian është një ceremoni që të detyron të rrih në një gatiu të respektueshëm.  
As Aristoteli këtë mesele nuk do ta kuptonte.  
Filozofi i madh nuk e ka ditur se kush janë aristokratët e pasluftës.



3. Nuk është për t'u çuditur pse është kaq i madh interesimi për përfitimet personale.  
Në fillim dhe në mes, njeriu nuk i beson njeriut.  
Mos ia futni kot!  
Tani hieroglifet i kemi lënë për të jetuar në mbretërinë e vet të vdekur.  
Ky shekull është shekulli i pasqyrave të cilat qa sa t'i afrojnë ngjarjet, t'i largojnë ngjarjet.  
Të palarat e jetës kur i qesim në det, deti na i kthen.  
Kur i qesim në zjarr, zjarri e humb durimin.  
Shpejt e ngadalë dalim te Kali i Trojës.  
Në një vend tjetër nuk po e kuptojmë se çfarë loje po luhet.  
Jeta si shumë klishe të njohura e të panjohura të jetës, për kohën që ka vdekur e ka famën e Titanikut të fundosur gjatë lundrimit të parë.  
Ky realitet i afërt me vdekjen, shpesh më ka bindur dhe më ka futur në rrezik.  
Tani ndoshta askush nuk e kupton.  
Derisa ndodhë diçka që duhet të ndodhë.  
Me njerëzit nga lumi.  
Me njerëzit nga zjarri.  
Lëreni kohën ta kuptojë kohën.  
Njohësit e vetvetes flasin me hesh-tje.  
4. Duke kërkuar mundësi për të jetuar, pashë hënën.  
E përshëndeta pa e ditur sa është larg dhe pa e ditur se kujt po i flas.  
Heshtja e saj më bën të lumtur.  
Tani nuk është as ditë, as natë.  
Për një lidhje që ndryshon mendjen, mjaft u ankova.  
Nga përplasja e derës, dikush theu derën.  
Filloi t'i numërojë minutat.  
Askush nuk është i përkryer.  
Jeta e njeriut është si ora: tak e tak e tak...  
Dhe kërcen tak.  
Dhe shkon edhe një minut.  
Ku mund të ndalemi nuk e di.  
E ardhmja është larg.  
Përpara një dyshimi, nga përplasje na jetën, copë e grimë.  
Nga zhgënjimi, copë e grimë.  
Me njeriun cinik.  
Greqisht fjala cinik do të thotë qen.  
Për të frymëzuar një ide edhe shqig qenit i thonë qen.  
Kur nata bie mbi gjithçka që është njerëzore.  
5. Sa kemi prituri që të na vijë kjo ditë.  
Dhe prapë na erdhën hesapet për të thënë: Më keq nuk ka qenë as kur Caribashi e humbte durimin dhe ndjenjën e moralit.  
Por tani çka të themi për famën.  
Edhe fabrika e patriotëve tanë sojlinj botën e mbushi me intriga, hajni e lakmi.  
Siç po shihet sot gjithçka është lojë.  
Dhe çdo gjë mashtrim.  
Gjejani hallin pse.  
Mbreti i rrejshëm na ishte edhe i verbër.  
Shegeri ia kishte ngrënë shikimin dhe mendjen.  
Me shkarravina historike nuk na la as portret, as autoportret dhe as personalitet.  
Për kohën që po jetojmë, ku mund të shkojmë nuk e di.  
E ardhmja është larg mendjes.  
Përpara një dyshimi.  
Nga përplasje me jetën, ka ardhur koha të frikësohemi edhe nga vetvetja.  
Publikisht flasin se jemi mirë.  
Idetë e luftës po na e kujtojnë luftën e cila dikujt po i sjell fat e popullit zhgënjim.  
Doni e s'doni çdo gjë e ka përgjigjen në xhep.  
Edhe mendimi njerëzor është luftë.  
Çka na pret jam lodhur duke prituri.  
Le të vie çfarëdo zemani, më keq nuk bëhet.  
Me Kalin e Trojës dhe për Kalin e

Trojës, cila është e ardhmja?  
Më kishë e xhami ndoshta nuk është fundi i botës.  
6. Dervishi që flinte nën Urën e Vezir-it, tha:  
"Edhe gjatë luftës, edhe pas luftës lejohet çdo gjë. Nuk e kemi të gjallë Zeusin e Dodonës, që lëshonte rreftë si armë për të na brojtur nga e keqja."  
- Ku është liria? - e pyeta / "Liria po ecën, por nuk po shihet. I ka humbur shpresat. Besimit i ka vdekur nëna. Për t'i qitur kapak kësaj historie, gënjeshtër është mbi sundimin e ligjeve. Derri ku arrin e keqja e ditëve tona e shoh përmes gishtave. Më duket shumë trishtuese. Pa therrë në këmbë i ka thyer të gjitha rekordet. Nga koha e humbur u bëmë më të humbur. Nëse nuk e shihni veten nuk do ta kuptoni se as kush jemi! Jeta skandalozë na vjen keq e më keq. Pas një lufte tjetër do të më kuptoni më mirë dhe do të pritni aq sa kam prituri unë".  
Me dy ditë shkollë e pa thellësi diplomatike, kësaj marrëzie kush do t'i jep fund?  
E keqja i ka rrënjët e thella.  
Kam edhe shumëçka tjetër për të thënë.  
Jo vetëm për lecka e pecka mbi tokë.  
7. Me këta sojlinj ç'kuptim ka jeta.  
Në fillim jetën e pashë si ëndërr.  
Sa vlen të flasim për të nuk e di.  
A ia vlen të shqetësohemi për të, po ashtu nuk e di.  
Ndoshta na duhet ta kuptojmë pse jetojmë.  
Për të shkuarën e kemi nisur mozaikun e autoportretit.  
Lufta nuk është vetëm luftë.  
Për të fyer mendjen dhe për ta puthur fundin, me leje e pa leje, me ligje e pa ligje, kohën e kemi lënë të hapur.  
Mund t'i hip kush të dojë.

Para syve po na kalon fama e rrejshe.  
Për kafshatën që na ka mbetur në fyt, çka po kërkojmë ashtu kot.  
Uluni në gjunj dhe çojani pak fitilin.  
Na ishte kur na ishte një Gjergj Elez Alia me nëntë plagë.  
Ku e ka varrin nuk ka shqiptar që e di.  
A ia vlen të sheqetësohemi po ashtu nuk e di.  
Në Shartashi jeta nuk quhet jetë pa thënë: Erdha nga lufta! Po shkoj në luftë!  
Tani çfarë kuptimi ka lufta kur kemi frikë edhe nga koha që nuk e kuptojmë.

8. Më falni për shqetësimin e papritur.  
Për të kaluarën dhe për kohën e fundit me mbeturina.  
Me disa ide që nuk po mund të lindin.  
Në Shartashi nuk është hera e parë.  
Aty, pas çdo lufte, fatkeqësitë fluturojnë qorras.  
Kujdes!  
Gjatë rrugës, deri aty ku kemi të drejtë kemi qenë gjithmonë sipas fjalëve. Tani po ecim në katër këmbë.  
S'patëm nevojë të kthehemi.  
Ku të kthehemi?!  
Nuk e durojmë as të kaluarën e as kohën e ardhshme.  
Si zakonisht zjarri me këmbë të kuqe na jep kënaqësi.  
Në terr e kërkojmë xhenetin.  
Për një bisht sorre, fjalët e mendjes na i merr era.  
Për aq sa jetojmë dhe për aq sa jemi servilë, koha për ne nuk ekziston.  
Krejt çka kemi thënë po del se paska qenë mashtrim.  
Sekreti është vetmia e historisë së pashkruar.  
Për të qenë të zotët e vetvetes, ku ta gjejmë atë besim!  
Me dyqind vjet vonesë asgjë nuk na kujtohet.

9. Nëse vazhdojmë kështu, kush do ta thotë të vërtetën?  
Populli po shndërrohet në shërbëtorë e jo në pronarë.  
Ku ta qesim pikën?  
Ku ta hedhim dyshimin?  
Jemi në luftë ku nuk shihet asgjë.  
Ndoshta do të fillojmë të shfaqemi si vampira.  
Për një gram drogë njeriu ia hëngër zemrën njeriut.  
Më shumë se shumë, mundësitë i kemi.  
Pa horizonte diplomatike, rubikoni nuk kalohet lehtë.  
Kush do të flasë për dashuriçka, për prostitucione politike.  
Harku i rrotës do të na çojë deri te përllat e "Njëmijë e një netëve".  
Deri te Ali Baba me dyzet hajdutët e vet.  
Të hunit e të konopit.  
Dhe e dyta: Ku po ndalemi, ku po shkojmë?..  
Në luftë për diçka tjetër nuk po shoh asgjë.  
Bjerini rrotull!  
Kjo marrëzi me pamje dëshpëruese po vazhdon  
Si arritëm ta vrasim lirinë?  
Përgjigja është e thjeshtë.  
Gjithë ditën kam pyetur pse...  
Na u mjeriz jeta.  
Nuk jemi mirë...  
Nëpër terr të posaçmendur...



## P

## POEZIA

Autori e lëvront prej kohësh poezinë dhe këtë e shikon në gamën e gjerë të perceptimeve që përcjell në këtë cikël. Trishtimi dhe humbja e shpresës duket se është lajtmotivi i përbashkët në të gjitha këto poezi...

NGA ALFONS ZENELAJ

**BOTA**

Asnjë fjalë  
germat s'mi nxë.  
Në gojën e shqyer të këngës  
tash e tutje jehon vetëm ti.  
Asnjë sy  
nuk m'i nxë më shikimet.  
Trupi yt  
shkruhet ethshëm i kuq  
në ballin e ftohtë  
të motit.  
Asnjë buzë  
s'e nxë dot frymën.  
Heshtja i thur vetvetes  
himm.  
Një himn  
për diellin  
që lind në Perëndim.

**KRONIKE AJRORE**

Një flurudhë e rrezikshme, jeta ish,  
petale drithërimash mbi qiellin blu.  
Pastaj "gabim njerëzor": avioni puth tokën.  
Kujtimet si pasagjerë vdekur aty këtu.  
Koha heton ftohtë mbi rrënoja dhe bar  
të gjejë fakte, këngë, lot apo një sy...  
Shpirti si një kuti e zezë avionësh  
ruan në vete vetëm vjershat për ty.

**KOHA ESHTË**

Eshtë koha të vdesim prej zërit në zë,  
diku përtej jetës, thellë në të vërtetën,  
veten t'ia blatojmë një brendie tjetër  
n' altarin kur jemi të kaltër me veten.  
Eshtë kohë e rëndësishme stinësh dyzuar,  
ngjizur brenda nesh me farën e klithjes  
dhe të durimit heshtor që nderet fener  
në netët pafund, stacioneve të pritjes.  
Eshtë kohë e rëndësishme. Tik-take të vde-  
kur  
mbi fushën e bardhë të orës pa vija  
ku vargjet për ty si Trekëndësh Bermunde  
përpijnë gjymtyrët dhe shqisat e mia.

**MENDIMI I HESHTUR**

Mendimet kanë qiell  
nën qiellin e retë.  
Pastaj  
poshtë tyre lëkundem unë:  
mirazhi të cillin  
vetë e pashë ndër stinë të reja.  
Mendimet janë re,  
retë  
shënojnë vajtime të ëmbla.  
Mbi kokën time,  
ujisin bimë të kuqe largësish,  
bar të egër mospendimi,  
lulefati të çuditshme moskuptimesh.  
Mendimet  
zvarriten në tokën e squllur  
prej shenjtëve të rrejtshëm mëkatarë,  
prej klithjes së verdhë të mallkimit tim  
dhe çarten në fjalë, ne gjepte të ajërt  
plumb.  
Pranvera po vjen vjeshtërisht  
dhe ti sa dhimbshëm po humb.

**UDHA**

Kishte kohë.  
Kishte pafundësi.  
Nuk ngutej.  
Këmishën me luleëndrre  
vishte ngadalë.  
Kishte mendimin të dukej i bukur  
kur të takohej me ty.  
Flokët ia krihte ky mendim.  
Ah sikur të kish ngrënë pak bukë,  
sikur të kish pirë pak ujë.



I la në parvaz për zogjtë e trupit  
kur të sillnin lajme ekzistence.  
Kishte hapësirë.  
Qiejt rignonin perëndim prej shirash.  
Në fund të tyre heshtje ti si letër dashurie.  
E mbylli derën  
me magji shikimesh.  
E mbylli si buzë që fjalën kurrë s'do ta thotë.  
Të mos hynte askush, asnjë sy.

U nis.  
Në rrugën pa asgjë,  
nën diellin përvëlues të mallit  
si hije të gjatë të lëshonte ty.

**KRISHTLINDJE**

Zotni, të lutem  
më fal ndoj festë se jam i gezuem,  
më fal pak festë t'lyeme me trishtim  
dhe një lodër plastike  
t'ia njis synit deri në dhimbje.  
Zotni, të lutem  
më fal ndoj g'zim të kaltër se jam plot festë,  
më fal një buzë g'zimi t'heshtun kuq  
se jam lodhë varun ndër degë krentimesh.  
Zotni, të lutem  
më fal një kordë të formoj korin satanik,  
më fal ndoj tel të vdekur drithërimash  
dhe t'ia ngjis vetes prej shpirti në shpirt.

Zotni, të lutem  
më fal një "Zoti të dhashte"  
që ta zbkuroj pemën tande kët ditë.

**PERENDIMI ATJE**

Nuk asht kurrë  
me u cu n'mjes

dhe me hap dritaren  
e me i trembë andrrat,  
me i nxjerrë jasht.  
Le t'ikin n'vrap e tmerr  
andej kah patën ardhë  
nji motmot në vitin Perëndim.  
T'ikin njashu t'verdha, t'ndalueme  
t'lidhuna përfyt t'njana tjetrës  
e t'iu ngjiten si lara gjarpnive  
t'kohës time pa ty.  
Nuk ka problem.  
Le t'mesin bosh gjymtyrët e mia  
le t'mos shkruaj ma kurrë me brinjën e  
thyeme të gjoksit  
asgja prej rreshtash  
dhe prej bimësh kacavjerrëse.  
Bardh si e zeza le t'mbesin shkret  
muri-Jerusalemi i lutjeve tona,  
t'mos ketë lukuqe kurrkund,  
t'orientohen hapat, durt dhe flokët që ti  
s'mujte.

Asgja, moj mos t'më mesin përmbi Kryq e  
Hanë  
pervec premtimeve t'papremtueme.

**DILEME FATALE**

A thue brenge i ke vu krahe  
dhe shtigjesh te tjere e ke nise.  
a thue bashke me folene nder shpirt  
e ke perflak qiejsh te tjere?  
M'kallo o tingull fatal  
qe ndale kohen,  
qe m'ndale mue.  
Pa m'thuej ku ta prangoj vetveten  
kur jeta rreshket  
si vezullim hijesh dhe muresh qe flasin pa-

pra...?

A thue gzimin e ke fik nder gezime,  
a thue kanget i mbyte nder kange?  
M'thuej  
ku frymuen se fundmi ahete e tu,  
Pse fati shkimbet si jete  
dhe bahet hini i synit tim,  
bahet asgja...?

M'thuej  
si vdiq heshtja jeme,  
andra jeme ne cilin kuptim  
varrin e ka?

**TOKA IME**

Toke e çuditshme,  
toke prej lekure.  
Lekure te lene nga zvarritjet tona.  
Toke e mire, zbkurouar me mort,  
toke e trishte si kuqelim qershish  
kur vonon dashuria.  
Toke ters, peme e zhveshur  
qe numuron eren e mallkimit tone.  
Toke beze, kostum, tanga,  
toke atletike firmato  
qe puth kembe terri kur vjen fundi-  
fundit yt toke e yndyrshme,  
govate, legen, kazan.  
Vlon te palarat e mijevjecareve papushim,  
Toke hotel kambistesh, ardhacakesh,  
tufash te babazitura, te trashura me mekat  
qe kafshojne lumenjte.  
Toke e qullur nga etja,  
e etur nga e verteta.  
Toka ime  
e bere dhe, ajer, fir  
ne agoni per shikim prej syri,  
per nje kengez bime,  
per nje fjale are.

Toka ime plake,  
o plake e cmendur, flokeshprishur, e lene  
eja e na sperkat me kuje mbi varre.

**YLLI MBI QYTET**

Te gjithë janë në gjumë,  
vetëm qyteti s'fle.  
Mendon për gjëra të mëdha  
e të vërteta  
Për parqet, rrugët,  
lumin  
dhe luminë që fiket  
thellë hijeve të veta.

Për çfarë ta pyes sonte  
qytetin që nuk fle,  
të vetmin ankh të bukur,  
po dhimbjen si t'ia them?  
Si ta mat natën time  
kur ëngjëjt më rrëzohen  
mbi ktë qytet të vogël  
me sytë e mëdhenj?

Qyteti im nuk fle.  
Nga smogu dhe nga stresi,  
nga dhimbjet plot me ngjyra  
nuk flemë un' dhe ai.  
Të qetë në këtë natë  
po dehemi me heshtje  
tek shkruajme këtë vjershe  
të vetmen jo për ty.

**CIRKUIDI NE VETE**

Koha kalonte, koha shkelte mbi mua  
e etur pamëshirë, e cmendur nga uria  
fshetur tinëzishit ndër skuta ndërgegjesh  
ushqehje papushim me shqisat e mia.

Kalonte, zvarritej shëndoshej kaba  
mbi shtatorin time të ngrirë pa ty.  
Gostive makabre gëlltiste vetmisë:  
ëndrra, pengje, gjymtyrë dhe sy.

Pastaj erdhi çasti kur s'kisha asgjë  
e koha u cmend, klithi, uleriti  
që s'e hante dot atë çka kish mbetur  
E krejt çka kish mbetur, ishte vetëm shpirti.

**L**  
LETËRSIA

# ERNEST HEMINGWAY

## Ja si më vjen të shkruaj

NGA GEORGE PLIMPTON\*

**J**u më keni shkruar dikur se rrethanat e zakonshme nën të cilën shkruat pjesë të ndryshme prej fikshenit tuaj mund të ishin edhe orientuese për atë që do vinte më pas. A e aplikuat këtë në të vërtetë tek "Vrasësit"-ju më keni thënë se shkruat në të njëjtën mënyrë "Dhjetë Indianët" dhe "Sot është e premtë" -dhe ndoshta këtë e bëtë edhe në romanin tuaj të parë "The Sun Also Rises"?

"Le ta shikojmë këtë me kujdes. "The Sun Also Rises", që e fillova në Valencia, përkoi me ditëlindjen time më 21 korrik. Hadley, ime shoqe dhe unë kishim dalë të gjenim bileta të mira për feriat, e cila zhvillohej më njëzetë e katër korrik. Deri më atëherë, çdokush nga krijuesit, që ishte në moshën time ia kishte dalë të shkruante një roman, ndërsa unë përballesh me momente të vështira, kur më duhej të shkruaja goftë edhe paragrafin më të thjeshtë. Kështu që e fillova librin bash në kohën e ditëlindjes sime, duke shkruar për gjithë kohën e feriat, fillimisht në krevat herët në mëngjes, e pastaj gjatë rrugës për në Madrid dhe ku të mundesha. Por, nuk kishte feriat atje, kështu që ne morëm një dhomë, ku gjendej një tavolinë dhe unë shkrova me shumë luks mbi atë gjë dhe përreth çdo cepi të hotelit në një vend birre në Pasaje Alvarez, ku më dukej se ishte freskët. Pastaj u bë shumë nxehtë për të vazhduar të shkruaj dhe në shkuaq në Hendaye. Atje, në këtë plazh të dashur të stërgjatë kishte një dhomë hoteli të lirë dhe ndjeva se po arrija të punoja shumë mirë... pastaj ikëm në Paris dhe draftin e parë e mbarova në apartamentin, që ndodhej sipër një kantieri sharre në 113 Rue Notre-Dame-des-Champs, fill gjashtë javë pasi e kisha filluar. Ia tregova draftin e parë Nathan Asch, një romancier, që shoqërohesha atëherë -ndërsa ai me një theks të fortë më shqiptoi prerë: "Hem, çfarë është doni të thoni me këtë që keni shkruar një roman? Një roman hën. Hën Ju keni bërë një libër udhëtimi". Unë s'u dekurajova nga Nathan dhe e rishkrova librin, duke e mbajtur në dorë gjatë udhëtimit (që ishte pjesa e një udhëtimi peshkimi dhe Pamplona) në Schruns në Vorarlberg deri në Hotel Taube. Ndërsa për sa i përket historive që përmendni dhe që unë i shkrova në po të njëjtën ditë në Madrid më 16 maj, përkoi me borën që binte në fushë-



luftimin e San Isidoro. Të parën që shkrova isha "Vrasësit" që isha përpjekur ta realizoja edhe më parë por kisha dështuar. Një moment gjatë drekës u futa në krevat të mundesha. Por, nuk kishte feriat atje, kështu që ne morëm një dhomë, ku gjendej një tavolinë dhe unë shkrova me shumë luks mbi atë gjë dhe përreth çdo cepi të hotelit në një vend birre në Pasaje Alvarez, ku më dukej se ishte freskët. Pastaj u bë shumë nxehtë për të vazhduar të shkruaj dhe në shkuaq në Hendaye. Atje, në këtë plazh të dashur të stërgjatë kishte një dhomë hoteli të lirë dhe ndjeva se po arrija të punoja shumë mirë... pastaj ikëm në Paris dhe draftin e parë e mbarova në apartamentin, që ndodhej sipër një kantieri sharre në 113 Rue Notre-Dame-des-Champs, fill gjashtë javë pasi e kisha filluar. Ia tregova draftin e parë Nathan Asch, një romancier, që shoqërohesha atëherë -ndërsa ai me një theks të fortë më shqiptoi prerë: "Hem, çfarë është doni të thoni me këtë që keni shkruar një roman? Një roman hën. Hën Ju keni bërë një libër udhëtimi". Unë s'u dekurajova nga Nathan dhe e rishkrova librin, duke e mbajtur në dorë gjatë udhëtimit (që ishte pjesa e një udhëtimi peshkimi dhe Pamplona) në Schruns në Vorarlberg deri në Hotel Taube. Ndërsa për sa i përket historive që përmendni dhe që unë i shkrova në po të njëjtën ditë në Madrid më 16 maj, përkoi me borën që binte në fushë-



dhe një shishe tjetër. Pastaj, shtoi se Senora donte të dinte nëse do të vazhdoja të shkruaja për të gjithë natën. I thashë jo dhe mendova që të shtriqesha për pak kohë. Pse nuk përpiqesh të shkruash dhe pak, më tha kamerieri. Unë përpiqem të shkruaj vetëm një herë, i thashë. Pa sens fare, m'u përgjigj. Ju mund të shkruani dhe gjashtë pjesë të tilla. Do të përpiqem nesër, i thashë. Provoje sot natën, tha ai. Nuk e kupton pse plaka të solli diçka për të ngrënë?

Jam i lodhur, i thashë. Pa sens, mu përgjigj ai (fjala nuk ishte pa sens). Juve ndjeheni i lodhur pas tre tregimeve fare mizerabël. Më përkthe një. Më lër vetëm, i thashë. Si mund të shkruaj, nëse ti nuk do më lësh vetëm? Kështu që u ngrita në krevat dhe fillova të pija Valdepenas dhe mendova se çfarë dreq shkrimtari i isha nëse tregimi i parë që kisha bërë do të ishte direkt i arrirë".

Sa i plotësuar është në mendjen tënde, që në fillim-

koncepti i tregimit të shkurtër? A ka të ngjarë që tema apo fabula apo personazhet të ndryshojnë ndërsa ju lëvizni me shtjellimin?

"Ngandonjëherë, ndodh që e dini historinë që më parë. Ngandonjëherë, ndodh që e sajoni atë të lëvizë dhe nuk e keni fare idenë sesi do të dalë. Çdo gjë ndryshon ndërsa lëviz gjithnjë e më ndryshe. Kjo është ajo që e bën lëvizjen dhe bash ajo që e krijon nga ana e saj historinë më pas. Ndodh, ngandonjëherë që lëvizja është kaq e ngadaltë, sa që nuk duket se po lëviz fare. Por ka gjithnjë ndryshim dhe gjithmonë lëvizje".

**Ndodh e njëjta gjë me romanin apo e punoni ju fillimisht planin përpara se të filloni dhe pastaj i mbështeteni atij në mënyrë rigoroze...**

"Për Whom the Bells Tolls (Për kë bien kambanat) hasa një problem në linjën e tij, ndaj, më duhej që t'i përmbahesha çdo ditë. E dija se çfarë do të ndodhte në princip, që pa u ulur fare të shkruaja. Por zakonisht unë e shpik atë që ndodh për çdo ditë, që shkruaj".


**A është e vërtetë kjo se tek Green Hills of Afrika, To have and have not dhe Across the River and Into the Trees të gjitha fillojnë si tregime të shkurtra dhe pastaj ndodh që zhvillohen në romane? Nëse ndodh kështu, a ndodh që dy format të jenë kaq të ngjashme sa që shkrimtari të kalojë lirshëm nga njëra tek tjetra pa e mbaruar komplet përpunimin e prejeks së tij të një tekstit?**

"Jo, kjo s'është e vërtetë. The Green hills of Africa nuk është një roman por është shkruar në një përpjekje për një libër të vërtetë, ku duhet shikuar nëse hija e një vendi dhe struktura e një veprimi mujor- është arritur të jepet si duhet në mënyrë t'i shkojë punës së një imagjinate. Pasi shkrova atë, mbarova edhe dy tregime të shkurtra "The Snow of Kilimanjaro" (Dëborat e Kilimanxharos) dhe "The Short Happy Life of Francis Macomber". Këto ishin histori që i shpika nga njohuritë që kisha dhe eksperiencia e fituar në të njëjtin udhëtim të gjatë një mujor gjuetie, gjatë të cilit u përpoqa të shkruaja përshtypje shumë të besueshme të The Green Hills. To have and Have not dhe Across the River and Into the Trees, por të dyja realisht filluan si tregime të shkurtra".

**\*Marrë nga një intervistë në Paris Review. Përktheu nga origjinali Ben Andoni**

**P**  
POEZIA

*Përmbledhja që po botojmë na përshfaq krijimtarinë e fundit të autorit. Një poezi mirëfilli që bën sinteza të jetës dhe mundohet të përcjellë vëzhgimin e një krijuesi të mbarsur me ndjesi të përziera, dhimbje dhe sens perceptimi filozofik...*



NGA NIKOLIN GURAKUKI

### FARA E JETES

Në dollapin e dashurisë nuk ka vend për dashuri të tjera. Në portet e tua hyjnë e dalin anijet e emocion-eve, pasi shkarkojnë, ngarkojnë ngarkesen, e nisen në udhetime të largëta, të gjejnë limane të tjera. Horizontit lënd përflakët muzgu, e dritërohet agimi. Në prehrin e monopateve të tua ulem, e shfletoj faqet e librit tend grua. Lëndinat e tua i plugoj pa parmendë, e farën e jetës mbjell, në dherat e tua.

### RREKAJE SHIU

Në stërkala ditësh me shpërbëhet koha! Drita më kthehet në kllim të shurdhët rebelimi të lodhur. Lutjet si ruzare në duar, më kthehen në butësi delikate trishëmi, e loli më përumbet udhëve të vetmiste time. I embel ky lëndim, si ëndrra e një pulebardhe delikate, që ndihet plot përgjysëm nga malli, e fillon e ndjen vetmi, por kur e shuan ndihet si femi. Shpirtin nuk e shtrudh si leckë pastrimi, por e le të më lëndojë nga perqafimi yt në shi. Çader nuk dua mbi kokë që të mbrohem, kembëzathur në breg të detit eci me ty. Me shiun përqafohemi, e nuk kemi xheloz. Rrëkajet e tij mbi ne, pasaportë shpirtitash në liri. Ne e puthim shiun, e ai na puth ne. Në ishullin tonë përplot me shi e puthe,

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri mund të konsiderohet e mirë. Shkrimi kryesor iu la një argumenti të arkitektit Gjon Radovani për strukturën e muzeut të ri të françeskanëve. Ndërtimi i këtij muzeu është një sipërmarrje kombëtare, prandaj involvimi në procesin e punës për konceptimin e brendisë së tij kërkon një gjithpërfshirje institucionale dhe involvimin e subjekteve të specializuara, u shpreh arkitekti, që ka bërë dhe hartimin e konceptit përfundimtar të muzealizimit të kësaj trashëgimie të madhe kulturore. Një miku ynë Andi Papastefani, po arkitekt, na solli diçka për Notre Dame, duke na treguar dëmtimin dhe se ku do të ndërhyhet. Por, ndryshe nga çfarë na premtoi shkroi shumë pak. Do të dëshironim të dëgjoni diçka më shumë për restaurimin e këtij objekti, por zyrtarisht dhe jo verbalisht, sepse nga Andi mund të mësohet realisht.

Studiuesi Mehmet Elezi na kish sjellë prej kohësh një shkrim që ka gjetur mundësi të botohet vetëm këtë numër, ku nëpërmjet emërve të hershme në gjuhën shqipe prekim rrënjët tona. Duhet thënë se shjtjellimi i tij ishte tejet interesant, por dukshëm i ka mbetur hatri ngaqë u botua pak me vonesë.

Redaktori botoi një pjesë nga romani i Myslim Pasha, specialisti dinjitoz dhe publicisti i njohur që tashmë vjen së fundi edhe si krijues. Falë përvojës së tij të jash-

tëzakonshme jetësore, ngërthyer me një aftësi vëzhguese të rrallë, ai na ka sjellë një krijim, që besojmë se do të grishë dhe për gjini të tjera arti... Fazli Haliti, në këtë numër, erdhi me një poemë të këndshme me karakter kozmogonik, duke e shpërndarë shqetësimin e tij human drejt eterit të pafundmë. Redaktori vlerësoi kthjellësinë e ndjenjës dhe kujdesin me të cilën ai trajton figuracionin...

Vetë, redaktori, realizoi një ide sesi Shqipëria ende nuk ka një film të tregojë jetën e dytë nën Komunizëm nën presionin e Sigurimit dhe nën përkorjen absurde, njerëzit që shpëtuat prej saj dhe solidaritetin mes komunitetit; Shqipëria ende nuk ka një film ku mund të tregojë realisht tranzicionin, ashtu si nuk ka një film të mirëqenë të problemeve tona sociale, pa e mbushur dot me klishe, shkroi ai duke aluduar për vësh-tirësinë dhe kompleksitetin tonë ndaj sinqeritetit.

Wiktor Brumer erdhi pas shumë vitesh me një material i panjohur për Aleksandër Moisiun, që na ofrohet nga një njohës i mirë i kulturës po-lake, Leonard Zissi. Numri ishte faqosur shumë mirë dhe layout kishte punuar jo keq tek e fundit.



jemi ne të tre.  
Si mantel e kemi hedhur kraheve,  
të na mbroje nga paudhësitë,  
të na pastrojë nga ligësitë,  
të na ngjyrojë heshtjen me kalterësitë.

**KEMI**

Nuk kemi natë,  
as ditë nuk kemi më,  
nuk kemi dhimbje,  
nuk kemi më trishtime,  
nuk kemi më as rrugë,  
nuk kanë ç'na duhen më zhgenjimet.  
Ndaj kemi veç gëzime,  
kemi vetëm të vërtetën,  
ngarkuar mbajmë mbi shpinë,  
kemi kohën e pafund,  
kemi dashurinë,  
kemi pafundësinë,  
kemi përjetësinë.  
Kemi delin e paanë,  
kemi zjarrin që përpin,  
kemi jetel që s'njaltojnë,  
kemi zemrat tona,  
kemi dashurinë,  
kemi pafundësinë,  
kemi përjetësinë!

**MOS VALLE HARROVE ?!**

Mos valle harrove kaq shpejt?  
A e di ç'është dashuria?  
Eshlë dëshira e pashpërguar,  
të të kem pranë kur ti je larg,  
të të dëgjoj zerin tend  
edhe kur nuk të shoh,  
të pres çdo lindje dielli,  
me dëshirën e pashtrëshme,  
të të them mirmëngjes,

për të të shkruar papushuar,  
për të dëgjuar muzikë me ty,  
për të shkruar poezi për ty,  
për të dëgjuar dhajten e frymëmarrjes,  
rënkimet e tua me zerin e kënaqësisë...  
Oh, yess!

**NE**

Unë e ti jemi ne,  
bota aty është ku gjithmonë ka qenë,  
gjihtnji rrotullohet pa na pyetur ne,  
kurrë nuk ndërroi kahje.  
Kur nuk më kishë - isha unë,  
ti ishe ti!  
Asokohe nuk ishim xhelozë...  
Unë po të pres ty!  
Lumi yt rrjedh në det të egër,  
dhe shfleton faqet e kalendarit tim.  
Koha ime rrjedh,  
midis zemrës dhe këmbëve të tua.  
Tani jemi NE,  
ndaj nuk jemi xhelozë.  
Të gjithë janë mbytur ujërave të kohës,  
unë e ti jemi vetëm përmbi dhe.

**VRAPOJME**

Vrapojmë si të cmendur  
herë rrotull një rrethi,  
herë rrotull një trekëndëshi.  
Ngado që të silllemi,  
jemi në grackën e urrëjtjes.  
dashuria na pret jashtë,  
vetëm shpresa kthehet  
në pikën e heshtjes.

**EJA IKIM...**

Të thirra të vije tek unë shekuj me parë,  
kur akoma nuk kishim lindur as unë as ti.  
Nuk kishim trupa,

por shpirtat tanë njëheshin se largu,  
që në lashtësi.  
E ndjeja shijen tënde, dëshirën e pandalur,  
për t'u shkrirë në nji.  
Unë të thirra se e ndjeja se si merrej frymë,  
me mushkerite e mija,  
brenda trupit tim,  
si në heshtje vrapoje nëpër damarët e mi,  
me aromën dehëse të parfumit tend,  
në heshtje gdhende fjalën dashuri.  
Të thirra dhe ti erdhe,  
si mjellmë e ëndrrave të mia.  
Erdhe ngadale, me hap të brishtë,  
me buzëqeshje engjëjsh në buzë.  
U puthëm sikur ishim puthur miliona herë.  
Ma njëhije mirë brenqen,  
e dorën lehtë ma rreshqite mbi shpinë,  
thellë të vështrova në sytë e tu,  
aty pashë të shkruar emrin tim.  
Të thirra dhe ti erdhe,  
kisha mijera vjet duke të pritur,  
ti kishe mijera vjet që drejt meje udhëtoje,  
dhe hyre brenda meje pa trokullur,  
me sinjalin e një xixëllonje.  
Ti hyre dhe sollë me velet  
stinet e lulëzuara,  
flokët e lëshuara të erës,  
shpalose si pajën e nuses,  
buzëqeshjet e lua.  
Ti sollë me velet zjarrin e buzëve të tua,  
dhe sytë e tu magjepës,  
pas të cilëve marroset,  
Narcizi i dashuruar.  
Ti erdhe tek unë me dritën e mirësisë tënde,  
për të ndriquar ertërsirën e brenqës timë.

**PRANDAJ**

Lermë të vij me ty,

se zemra s'më është thijnur,  
drejt dashurisë gjithnjë çapitet fillikat.  
Lermë të vij me ty,  
e të ngjitem në majat e fladitura,  
nga ererat pranverore.  
Lermë të vij me ty,  
se këto kohera të purpurta,  
kam nderjur mbi shtratit tim,  
duke shkruar poezi të gdhendura në shkëmb.  
Kjo kohë mban aromë të vdekurish,  
e don të jetoje me të vdekurit.  
Lermë të vij me ty,  
se fryma po më zihet,  
dua ajër, ajër e dritë,  
të rizuaj thellësitë,  
se përjetësia ekziston,  
lumtura, dehja, ngazellimi,  
janë smeraldet e zafirët e mijë,  
ato unë velem ty ti dhuroj.  
Lermë të vij tek ti,  
ah, po,  
më prit pak sa të marr pallton,  
se ka pak lagështi.  
Hëna po na sheh,  
hijet kanë mbetur memece,  
plot mister.  
Eja, hidhemi në bregun ljetër,  
ajle na pret treni i pazhurme,  
i marramendjes drejt velvetes.  
Asgjë s'kam marre me vehte,  
as valixhe,  
por të gjitha poezitë,  
dhe velem dallqet e oqeanit të zemrës.  
Lermë të vij me ty,  
e bashkë kundruall hënës,  
ti lartësojmë vargjet  
hapësirave të kalterreme  
me në dorë harpen e Orfeut,  
e të çapitem ëndrrave me ty Euridika ime,

në koto ditë të pabjershme të slinës.  
Lermë të vij me ty,  
se në tokë shpërtheu blerimi  
i një qielli të lartësuar,  
nga lulet mbuluar.  
Shihje si buzëqeshja jote fluturon lart,  
me flatrat e pellumbave,  
përmbi lëndinat e luljeve tona.  
Lermë të vij tek ti Euridika ime,  
si një fluks të behem,  
brenda teje të digjem si diell!  
Lermë të përsosem tek ti...  
Të lutem!  
(Sipas një ëndrre)

**PULEBARDHES**

Një det dhe një qiell,  
nolotjnë në shpirtin tend pulebardha ime.  
Ti, kur më ulësh ditën përmbi direk,  
behesh princeshë e ndjenjave më intime.

Kur muzgut ikën në shteglim,  
e era më sjell lëndin tend valë-valë,  
vertebrat e shpirtit më kuisin me gëzim,  
e vehten e ndjej si një djale!

Atëherë, spirancën e ankthit,  
përmbi palat e arsyes hedh anija e shpresës,  
shishja e verës në tavolinën e pasionit,  
djersin nga sikletit i mungesës.

Unë e shishja po të presim,  
me veshët mbushur muzgut me jehonat e erës,  
eja pulbardhë përmbi kuverte,  
të shenjtëtojmë së bashku, aromën e verës.

Dheja, ti në dritën flakëruese shfaqesh  
të muzgut të gjakosur,  
e veshur me të bardha si hyjneshë ti dukesh  
e zellshme, e përsosur.

**UJI I KOHES**

Koha si uji rrjedh,  
hap brazdat e mendimeve në mendje.  
Deti është i kuq,  
pemët e verdha,  
një edhe një bëjnë tre.  
Tavani i arsyes po rikonstruktohet!  
Një buzëqeshje e vërtete ma ngjyros ëndrën.  
Retë tymnaja gënjeshtrash,  
ecin me hap njeriu në vesën e mëngjesit.  
Fluturimi i zogjve hap brazdat e qiellit,  
me flatrat e së vërtetës.  
Uji i kohës ndrin vërtetësisht,  
me ngjyrat e jetës.

**A E DI ?**

A e di ku është vendi yt?  
Aty ku koha nuk ka moshë,  
zemra rreh me takikardi,  
e fantazisë i mbahet fryma!  
Aty ku emocioni nuk plakët kurrë,  
e endrra fluturon me krahe engjëjlli,  
aty është vendi yt,  
në kontinentin midis dy kraheve,  
prej nga nuk mund të arralëshesh kurrë!  
Aty ku shpirti mbetet përjetësisht i ri,  
në grackat midis dy buzëve,  
aty ku fluturimi quhet dashuri,  
aty është vendi yt!  
A e di?



# R

## REVIEW

*Përkthimi dhe botimi i vëllimit me tregime të Arian Lekës, "Shpina e burrit" (Partizanska Knjiga, Beograd, 2018), nuk mund të merret asesi ekskluzivisht si sipërmarrje botuese, por edhe si akt politik par excellence, si akt i ndërmarrë në emër të prishjes së qetësisë të diktuar nga e njëjta politikë. Nuk jam i sigurt nëse botimi i këtij libri do të jetë i mjaftueshëm për ndryshimin e një narrative përmbysëse, që shoqëron në përgjithësi marrëdhëniet serbo-shqiptare. Por në emër të mirësjelljes elementare njerëzore dhe letërsisë së vërtetë jam i sigurt që "Shpina e burrit" i Arian Lekës është një prelude tejet i mirë i asaj çka letërsia shqiptare përshfaq sot, mbi çdo bazë dhe mbi çdo kriter.*

NGA SRDJAN SRDIÇ

P prej mëse dy dekadash krijimtaria letrare e Arian Lekës është botuar në disa prej gjuhëve të rajonit, duke filluar që me publikimin e esesë "Lindur në Provincë" 2005 dhe për të vijuar më pas me poezi, tregime, intervista dhe opinione të tilla si "Në kërkim të këmishës së humbur", "Zhdokja e Tjetrit nga harta meteorologjike", "11 Ese Akustike" (botuar nga "Plima" dhe "Knjizhevna radionica Rashic"). Kjo krijimtari është përcjellë me artikuj kritikë në revista letrare dhe shtypin kulturor si "Oslobodjenje"-Bosnjë-Bercegovinë, "Danas"-Serbi, "Apokalipsa"-Slloveni, "Nova Istra"-Kroaci, "Stozher"-Maqedoni, "Ars"-Mal i Zi.

Në në fillim të vitit shkriamari Arian Leka botoi në Beograd edhe përmbledhjen e tij me tregime të zgjedhura. Janë 22 tregime të shkruara në dhjetë vjet krijimtari, duke filluar nga ato të vitit 1994, kur

Arian Leka botoi librin e parë me tregime "Ky vend i qetë ku s'ndodh asnjë", deri në vitin 2005, kur u botua përmbledhja me tregime "Shpina e burrit".

Pikërisht këtë titull mban edhe përzgjedhja e tregimeve në gjuhën serbe "Muzhevlevja legja". Libri është botuar nga "Partizanska knjiga" nën përkthimin e Gjorgje Bozhoviq-it. Shënime kritike që kanë shoqëruar botimin kanë theksuar se Arian Leka në këtë libër përdor teknika postmoderne, metafizikë, fiction-dokumentar, përdor paranojën kolektive, eu-



forinë e masës, si dhe një dozë realizmi magjik, mbërritur më fort nga fabulat përrallore të vendit të tij se sa nga shkolla amerikanolatine.

Arian Leka shfaqet si shkriamtar që tërhiqet nga marrëdhëniet familjare në një mënyrë jo të përditshme, nga marrëdhëniet të mbujtura në përditshmërinë shqiptare dhe nga errësira e tranzicionit, mbajtur në ekulibër mes çështjes universale të organizimit shoqëror dhe shtegut lokal të kohës historike. Në vijim pasthënia e shkriamtarit Sr'an Srdiç?, që shoqëron botimin në gjuhën serbe.

## “Shpina e burrit” - tregimet e Arian Lekës në Beograd

# KOHA FAMILJARE E ARIAN LEKËS

NGA SRDJAN SRDIÇ

Një nga shenjat më të përgjithshme në tregun letrar të vendeve ballkanike sot, dhe kjo përfshin edhe sistemin e shkollave, ka të bëjë me mungesën akute të përkthimit të librave të autorëve nga vendet fqinje, qofshin këta bashkëkohorë apo klasikë.

Aspak më mirë nuk paraqitet situata në sistemin shkollor të këtyre vendeve - literatura e detyruar përfaqësohet, ku më shumë e ku më pak, në mënyrë identike në përzgjedhjen e ligave të para botërore, ndërsa hedhja e syve tek ajo që lind pothuaj tek gardhi është krejtësisht e pamundur.

Këtu janë edhe pasojat më tragjike të kësaj lloj politike, sepse fjala është gjithësi për një politikë që vendos mbi fatet e dhënie-marrjeve letrare, të cilat mund të gjenden në vendet ku qytetarët janë të të njëjtës fantazi, gjuhës sonë: në Kroaci, Mal të Zi, Bosnjë Hercegovinë dhe Serbi.

Pikërisht nga veprat që vijnë prej këtyre trevave kohëve të fundit mbërrijnë edhe sinjale që dëshmojnë synimin e transferimit të gjurmëve të fundit të fqinjësisë letrare, por edhe të dëshirës për të njohur më parë veten, makar përmes leximit.

Ndoshta nuk është vendi të përmendim sesi socializmi nuk shkëlqeu në këtë çështje, ndonëse edhe në atë epokë politike, të cilën shpesh e konsiderojmë ekstremisht jokritike, në sensin pozitiv dhe negativ, letërsitë e fqinjëve përktheheshin dhe përfshiheshin në

programet shkollore, anipse fillimisht me vizoren e veprave të rëndomta, por edhe të përjashtimeve egzotike.


Lexusi i dikurshëm jugosllav kishte dije mjaftueshmërisht të plotë mbi letrat në Bullgari, Rumania apo Greqi, por letërsia e përfaqësuar nga shqiptarë të Shqipërisë, apo goftë nga po ajo Jugosllavi, do të thotë nga Kosova, mbetej absolutisht e panjohur.

Situata postjugosllave vetëm se e ka zgjuar këtë problem, ndaj edhe në kujtesën e atyre lexuesve ka mbetur vetëm emri i Ismail Kadarese, por edhe ai i përkthyer jo-selektivisht, autor, veprat e të cilit po shfaqen sërish në Serbi viteve të fundit dhe jo rrallë si ribotime të veprave të përkthyer.

Përveç Kadarese, emër gjithësi europian, publikut i kanë mbërritur, me njëfarë ndroje edhe vepra të Beqë Cufajt, por edhe të emrave të njohur politikë Shkëlzen Maliqi dhe Veton Surroi. Kështu që përkthimi i vëllimit me tregime të Arian Lekës, "Shpina e burrit" (Partizanska Knjiga, Beograd, 2018), nuk mund të merret asesi ekskluzivisht si sipërmarrje botuese, por edhe si akt politik par excellence, si akt i ndërmarrë në emër të prishjes së qetësisë të diktuar nga e njëjta politikë.

Thënë kjo libri i Arian Lekës përbën gjithësi një surprizë në kuptimin e një prezantimi të ri të letërsisë bashkëkohore përpara lexuesve serbë, por jo më pak edhe nga aspekti i ushtrimit poetik.

Që nga tregimi i parë, Prej nga vjen drita, e deri tek tregimi i njëzet e dytë, ai që mbyll librin Shpina e burrit dhe që titullohet Arma mis-



### Përveç Kadarese...

Përveç Kadarese, emër gjithësi europian, publikut i kanë mbërritur, me njëfarë ndroje edhe vepra të Beqë Cufajt, por edhe të emrave të njohur politikë Shkëlzen Maliqi dhe Veton Surroi. Kështu që përkthimi i vëllimit me tregime të Arian Lekës, "Shpina e burrit" (Partizanska Knjiga, Beograd, 2018), nuk mund të merret asesi ekskluzivisht si sipërmarrje botuese, por edhe si akt politik par excellence, si akt i ndërmarrë në emër të prishjes së qetësisë të diktuar nga e njëjta politikë.

terioze, Arian Leka shfaqet si shkriamtar i obsionuar nga marrëdhëniet familjare në një mënyrë jo të përditshme, sot në dukje ar-

kaike, alla Danilo Kish.

Ato janë marrëdhëniet të mbujtura në përditshmërinë shqiptare, nga ato që kanë prapa figurën monolite të Enver Hoxhës, tek ato të errësirës së tranzicionit në ndërkohë vështirësisht të përcaktueshme, deri në ato të ditëve tona. Me këtë Arian Leka ia ka dalë të ruajë një ekulibër mes çështjes universale të organizimit shoqëror dhe shtegut lokal të kohës historike.

Tregimet e shkruara me këtë çelës familjar (Album me Xhabir dhe Xhebrail, Brisk, Zogjtë e piktureave...) përbëjnë shpesh dëshmi mbi misteret e kompleksitetit të këtyre marrëdhënieve, mistere apo sekrete që duhet të qëndrojnë aty ku misteret qëndrojnë, tek trysnitë dhe mbingarkesat që burojnë në thelb apriori nga konstrukcioni i komunitetit njerëzor.

Në këtë korpus tregimesh Arian Leka i rezervon vetes të drejtën për një farë indulgjence si mospranim të thekave të rënda të ironisë, pjellë e një të kuptuari që vjen nga shfaqja e tij, nga një mungesë simpatie tek acarime radikale.

Krejt ndryshe duken tregimet që merren me fatin e emigrantëve shqiptarë pas vitit 1991, të atyre që masivisht braktisin një nga vendet më të varfra të Europës në fund të shekullit të shkuar, në kërkim të strehës përtej Atlantikut, por edhe në Italinë fqinje.

Cikli emigrant i tregimeve ndërtohet me tekste pakrahasimisht më të dhimbshëm, të tillë që shkaktojnë hidhësi dhe ngarkesë leximi, për shkak të identifikimit të drejtëpërdrejtë dhe të papenguar me vik-

timat historike të padyshimta, nga të cilat nuk ka pak anekënd Ballkanit.

Dy janë tregimet nga ky korpus tematik më sinjifikativë, Academic Orgasm, por në radhë të parë Pema, tregimi im favorit në gjithë librin e Arian Lekës dhe prej ku, nga perspektiva e një fëmije, duken vuajtjet e emigrantit dhe tmerrri që i ndjek ata, çka i kontribuon drejt përditshmërisë, por edhe zmadhimit të mundimeve para tablove të natyrës njerëzore, të pandreqhme dhe të keqe.

Në fund, por jo më pak të rëndësishme, qëndrojnë tregimet e tipit eksperimental (Krijimi i njeriut të ri, Ftesa, Dritare nga fusha...), ku vërehet aspirata e Arian Lekës ndaj veprimit, të cilin mund ta quajmë metafiction të metafiction-it, një lojë për llogaritë të postmodernes, epokës së mbyllur në qorr-sokakun e veprimeve të vdekura, të pakuptimta.

Jam i sigurt që Shpina e burrit i Arian Lekës është një prelude tejet i mirë i asaj çka letërsia shqiptare përshfaq sot, mbi çdo bazë dhe mbi çdo kriter.

Nuk jam, më anë tjetër, i sigurt nëse botimi i këtij libri do të jetë i mjaftueshëm për ndryshimin e një narrative përmbysëse, që shoqëron në përgjithësi marrëdhëniet serbo-shqiptare, kaq naiv dhe ambicioz këto vite nuk mund të jem. Por që në këtë gjest ka gje të të vloga, që dinë të jenë të mjaftueshme, këtë e di me siguri të plotë. Në emër të mirësjelljes elementare njerëzore dhe letërsisë së vërtetë.

**Përktheu nga origjinali  
Astrit Beqiraj**

Opinion i Ditës

# Dështimi i propagandistëve të idesë së Vuçiçit

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... të perealizueshëm. Kur dikush i kundërshtonte me principin mbi të cilin është ngritur rendi i sotëm i paqes, atë të pandryshueshmërisë së kufijve, kur dikush debatonte me ta mbi pamundësinë e realizimit të kësaj hipoteze që hapte "Kutinë e Pandorës" në Ballkan, kur dikush përmendte përdhosjen e vlerave europiane të multietnicitetit dhe bashkëjetesës, ata të jepnin gjithmonë një përgjigje simpliste dhe njëkohësisht përbuzëse.

Mos po bëhesh merak si internacionalistë për popujt e tjerë? Kush e ka çarë kokën për shqiptarët, që tani, ne, të mendojmë edhe për fqinjët? Ç'punë kemi ne kur zgjidhim hallin tonë, nëse flaka bie të komshiu?

Pra me një fjalë, Kosova dhe Serbia duhet të bënin paqe mbi principin e ndryshimit etnik të kufijve, pavarësisht se marrëveshja e Dejtonit përfundonte në kosh, pavarësisht se shkëputja e Republika Serbska e hidhte në erë Bosnjën, pavarësisht se edhe kroatët mund të kërkonin pjesë të saj, pavarësisht se Maqedonia e Veriut mund të vinte në pikëpyetje ekzistencën e mëpasshme, e kështu me radhë.

Por, kjo filozofi sa mendjeshkurtër, po aq e zhveshur edhe nga çdo vlerë, mori një përgjigje të qartë në samitin e Berlinit. Po të shikohet përbërja e asaj tryeze, ajo është kuptimplotë. Prezenca e Kroacisë dhe Sllovenisë, dy shtete që janë tashmë në BE dhe i kanë kapërcyer sfidat e vendeve të Ballkanit Perëndimor, nuk qe një koincidence e pamatur me kujdes. Ato që më parë qenë shprehur kundër idesë të rrezikshme të ndryshimit të kufijve.

I menduar në mënyrë edhe më perfide nga organizatorët që qëndrimi i kryetari i Këshillit të Ministrave të Bosnjës e Hercegovinës, Denis Zvizdiq, i cili në takimin me dyer të mbyllura arriti të përmendë edhe ringjalljen e fantazmave të luftës.

Nuk qe i rastësishëm fakti se ai "u gjend" në të njëjtën linjë me qëndrimet e kancelares gjermane.

Kur Hashim Thaçi dhe më pas Edi Rama mbështetën në gushtin që shko i idenë e Aleksandar Vuçiçit për këmbimin e territoreve dhe popullsisë, Merkel zgjodhi të shfaqet në krah të Zvizdiq, për të shpallur: "Integriteti territorial i vendeve të Ballkanit Perëndimor është i përcaktuar dhe i paprekshëm. Kjo duhet të përsëritet gjithnjë, sepse ekzistojnë tendenca që çështjet e kufijve të hapen sërish. Kjo nuk mund të ndodhë (13 gusht 2018)".

Edhe këtë javë në Berlin, pas paralajmërimeve për luftë që bëri në sy të Emmanuel Macron, kryem-



inistri i Bosnjës u tregoi mediave se presidenti serb, Vuçiç ishte inatosur keq me të për shkak të shkelmit që i dha kësaj ideje. "Vuçiç nuk e duroi dot faktin që unë tregova se rivizitimi i kufijve në linja etnike në Ballkan gjatë viteve të '90-ta ka përfunduar me luftëra të përgjakshme", i tha ai gazetës

"Slobodna Bosna".

Kjo e bëri liderin e fortë serb që kur u kthye në Beograd të deklaronte se ideja e nisur prej tij kish-te dështuar.

Bashkë me të dështuan edhe të gjithë ata shqiptarë që i vunë gjoksin asaj.

Dhe kur thuhet kjo, fjala nuk

është aspak për dokrra me patriotë e tradhtarë, siç pretendojnë opozitat në të dyja anët e kombit. As me historitë që ne tregojmë rëndom për të shiturit tek shkja apo spiunët e Serbisë.

Jo, aspak. Sepse mëkati i atyre që përkrahën planin serb në Tiranë dhe Prishtinë nuk ishte tradhtia, por mendjelehtësia për t'u mbështetur te një premisë sa naive, po aq edhe e pamundur.

Ata e arsyetuan rrugëtimin e tyre me parullën le të shpëtojmë veten, por flaka u rëntë të tjerëve.

Por, samiti i vendeve të Ballkanit tregoi krejt të kundërtën. Tregoi se ashtu sikurse pranoi edhe në fund presidenti francez, që u afrua me qëndrimin e Merkelit, nuk mund të ketë zgjidhje që cenon palët e treta. Për këtë arsye, Berlini ishte një fshikullim edhe për ata që verën e kaluar pyesnin me ironi: "Ç'na intereson ne, Bosnja dhe Kroacia"?

Pra me një fjalë, Kosova dhe Serbia duhet të bënin paqe mbi principin e ndryshimit etnik të kufijve, pavarësisht se marrëveshja e Dejtonit përfundonte në kosh, pavarësisht se shkëputja e Republika Serbska e hidhte në erë Bosnjën, pavarësisht se edhe kroatët mund të kërkonin pjesë të saj, pavarësisht se Maqedonia e Veriut mund të vinte në pikëpyetje ekzistencën e mëpasshme, e kështu me radhë..

## HOROSKOPI

### DASHI

Përpiquni të shmangni takimet me miq shumë të ngushtë, pasi mund të zhvillohet një bisedë, e cila nuk do t'ju pëlqejë aspak. Prioriteti për ju sot është përkushtimi ndaj vetes dhe të gjeni mënyrat më të mira për t'u ndjerë të kënaqur.

### DEMI

Sot do të jeni në qendër të vëmendjes. Kjo është mëse e arsyeshme për ata që kanë ndryshuar stil, ose për ata që kanë ndërmarrë një vendim të rëndësishëm në jetën e tyre. Mos i tregoni të gjitha planet për të ardhmen e afërt.

### BINJAKET

Do të befasoni nga sjellja e dikujt që e konsideroni mik të afërt. Ndoshta mund t'ju vijnë dhuratë shumë e çmuar, ose personi në fjalë t'ju bëjë një deklaratë të fortë dashurie. Ata që janë çift do të zbulojnë se partneripartnerja e tyre është më xheloz/e seç mund ta kishin menduar.

### GAFORJA

Mos konsumoni ilaçe pa këshillën e mjekut. Ka shumë gjasa që përpjekjet për të kaluar një problem shëndetësor në kushte shtëpia mund t'ua përkeqësojë situatën. Shmangni eksperimentet kreative apo rugët e panjohura.

### LUANI

Luanët mund të ndihen të mëzitur dhe të lodhur sot. Punët e shtëpisë do t'ju marrin shumë kohë dhe do t'ju vënë në provë durim. Mund të konfliktoheni me dikë nëse i përmendni të kaluarën e errët.

### VIRGJERESHA

Mos u bëni pjesë e thashethemeve ndaj personave të afërt me ju. Respektoni sekretet e të tjerëve dhe asnjëherë mos i gjykoni njerëzit nga paraqitja. Prioriteti për ju sot do të jetë jeta personale.

### PESHORJA

Sot do të ndihenitë mbushur plot optimizëm. Kaloni më shumë kohë me fëmijët dhe familjarët. Sportet dhe shëtitjet e gjata janë mjaft të mirëpritura. Ekziston mundësia që sot të kenë ide brilante, çfarë mund t'ju rrisë edhe të ardhurat tuaja financiare.

### AKREPI

Tema e kësaj dite do të jetë dashuria. Mendoni para se të veproni, mos ndërmerrni vendime të nxitura. Nëse ndodhni në një udhëtim të gjatë me familjen, mund të kenë momente të vogla konfliktuale.

### SHIGJETARI

Ka shumë gjasa që sot të kënaqeni pa masë. Mund të dilni me një mik të ngushtë, ose me dikë që e pëlqeni dhe dëshironi t'i shprehni dashurinë së shpejti. Për ata që preferojnë aventurën, është dita e duhur për të udhëtuar ose eksploruar.

### BRICJAPI

Do të vijoni të punoni për një projekt mjaft të rëndësishëm, i cili do t'ju sjellë të ardhura të kënaqshme. Megjithatë, ndërkohë që bëni një gjë të tillë, mos harroni planet familjare. Bëni kujdes kur bisedoni me të tjerët dhe mos i vini shumë në dukje arritjet tuaja.

### UJORI

Kjo ditë do të jetë mëse e zakonshme për të lindurit e kësaj shenje. Nuk parashikohet ndonjë event i veçantë. Nuk parashikohen probleme apo konflikte. Përpiquni të relaksoheni dhe të kujdeseni për shtëpinë.

### PESHQIT

Të lindurit e kësaj shenje do të fokusohen në përgatitjet për javën e ardhshme. Miqët do të kenë dëshirë të dilni e të argetoheni, por do të respektojnë dëshirën tuaj. Vizioni me planet tuaja dhe ndjehuni të lirë për të eksperimentuar.

Opinion i Ditës

# Armiku në tryezë

Nga Lorenc Vangjeli

(vijon nga faqja 1)

... zuzarë gjakftohtë dhe mëkatarë pa frikë në Perëndi, që prodhojnë fruta, perime e bulmetra me hormone të ndaluara, që përdorin pesticide të dëmshme për shëndetin në bujqësi e blegtori dhe dhjetëra metoda të tjera primitive, për të fituar ca qindarka më shumë.

Ky sojsojëzësh kriminalë gjendet kudo. Mes tyre ka fermerë, blegtorë apo importues që sjellin armikun në tryezën e çdo shqiptari. Ata vrasin ngadalë, por me siguri çdokënd dhe venë në shënjestër fillimisht ata që janë më të pambrojturit, fëmijët, gratë shtatzëna apo të moshuarit e sëmurë.

Kohët e fundit një seri denoncimesh në media e kanë risjellë në vëmendje shqetësimin e jashtëzakonshëm për ushqimin e përditshëm të popullatës dhe sigurinë e tij.

Specialistë të fushës gjithashtu në mënyrë të përsëritur kanë bërë apele për luftë totale kundër fatkeqësisë që mund të vijë nga



ushqimi.

Vetë prodhuesit, fermerë dhe përpunues, e njohin këtë problematikë dhe insistojnë në thellimin

e kontrolleve dhe në identifikimin e abuzuesve, por dilemës ndërmjet një realiteti dramatik dhe betejës së pandershme për

tregje, askush nuk i ka dhënë dot një përgjigje shteruese.

Edhe gishti i akuzës, edhe dora për ndihmë i drejtohet sërish sh-


tetit. Shumë shpejt ndryshimet në Kodin Penal do ta bëjnë burgun e gjatë, një përgjigje ndëshkuese për abuzuesit. Kush tregon me dije ushqime të dëmshme për shëndetin e konsumatorëve, është në të vërtetë një vrasës i mirëfilltë. Shumë më i rrezikshëm se një serial killer me kallashnikov në dorë apo me tritol në çantë. Kjo është vetëm një betejë që duhet të fitohet përballë kësaj sfide: identifikimi i përmasës reale të saj, çfarë është vërtet risk dhe çfarë ekzagjerim hilacakësh.

Siguria ushqimore është një hall real dhe përballë tij, edhe deklarimet e shumicës së Edi Ramës se do të vazhdojë të ketë mandat qeverisës edhe nja dy vjet të tjerë, edhe përбетimet e pakicës se do të kthejë përmbys Shqipërinë që të largojë Edi Ramën, ngajnë kaq të parëndësishme. Dhe duken kaq meskine dhe cinike, sa kohë që armiku i të gjithëve është në tryezën e gjithkujt. Një armik, ndaj të cilit nuk do pasur asnjë mëshirë, sepse edhe kjo kategori banditësh, këta vrasës serialë, vrasin dalëngadalë gjithkënd dhe pa asnjë mëshirë! (Javanews)

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

çdo të shtunë falas me GAZETA SHQIPTARE

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Mund të jetë kursimi.
5. Ylli i Nostradamus.
8. Tamam pa kufij.
11. Ross këngëtare.
13. I lashtë.
15. Është Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
19. Kufijtë e lëvizjes
20. I ka tek plepi.
21. Paguhen për shërbim.
23. Fillojnë lajen.
24. Kufizojnë trouaret.
25. Bëjnë karrierë në parti.
27. Thahet me bonifikim.
28. Mund të jetë unik një i tillë .
29. Preka komik shkordran.
31. Fund dhjetori.
32. Fillojnë aksionin.
33. Ente Operative Tiranë

34. Agjenci Ajrore Durrës.
36. Një pjesë e dimensioneve.
39. Është përfaqësuesja e Adriam Mutu.
41. Kalimi në ekstreme.
42. Është e re pas Krishtit.
43. Shkruhet për të mos vazhduar më.
44. Si i gjithë .
47. Kush e thotë lutet.
48. Kufij elementit.
49. Ishte nija që preu Aleksandri i Madh.
50. Një pjesë e titanëve.
51. Mund të jetë kundërmuese.
52. Pak titanike.

**VERTIKAL**

1. Si i përshtatëshëm.
2. Mund të jenë fetare.
3. Ai i kuq e ka një huq.
4. Pak analogji.
6. Është metri i roboqapësit.
7. Në hyrje të oazit.
8. Arte pa re.

9. Arthur që qe dramaturg.
10. Janë boshte.
12. Michelangelo regjisor.
14. Mund të bëjë stil të lirë .
16. Ishin monedhe te Tobias.
17. Është bas me katër tela.
18. Pak efikasitet.
22. Është marrëveshje me nota.
25. Ishte babai i Akiit.
26. Fillojnë nazet.
27. Në krye të kuadrove.
29. Është faqe muri.
30. Një apendisit i menjëhershëm.
35. Kurosawa që qe regjisor.
36. Vriten nga espada.
37. Është shtet aziatik.
38. Edouard piktor.
40. Një transporti është kamioni.
45. Uni i Freud.
46. Një cigan.
47. Fundi i një samurai.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

1. Fillojnë panikun.
3. Gibson aktor.
5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
9. Mund të jetë trofe.
11. Janë vendet si Katari
14. Maureen që qe aktore.
16. Janë kundërmuese.
17. Mund të fitojnë etapa.
20. Ushtojnë nga "ola".
22. Një thirrje
26. Janë ministritë.
27. Një rrugë në Paris.
28. Markë cigareje.
29. Është ngjinja.
32. Ricciarelli soprano.
33. Fillojnë sefte.

34. Ente Ekonomike Sarandë.
35. Mbyllin një ditar.
36. Satelit i Jupiterit
37. I ka tek Luani.
38. Boldi komik italian.
42. Është kolana në filma
43. Kush e thotë lutet.
44. Oxa këngëtare.
46. Inicialet e Nolte aktor.
47. Është tokë që... fitohet.
48. Një... gjermane.


**VERTIKAL**

1. Një votë në favor.
2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
3. Në hyrje makinës.
4. Fillojnë lehtë.




5. Irlanda në Dublin.
6. Është edhe ajo e historisë.
7. Një pjesë e gamijëve
8. Notat pa kufij.
9. Ishin komitë.
10. Ka kryeqytet Islamabad.
12. Don... i Interpretuar nga Terence
13. Mbyllin aktet.
15. Janë përmasa.
18. Gjysma e lutjes.
19. Castellito aktor.
20. Inicialt e Dalí, piktor.
21. Tanita këngëtare.
23. Është trysni
24. Në hyrje të Europës.
25. Janë rrobat për t'u larë.
30. Bën mëza.
31. Moreau aktore.
32. Janë thika.
39. Një pjesë e satelitit.
40. Janë teke në sende.
41. Pak maramendëse.
42. I ka tek zdapi.
45. Inicialet e Nolte-s.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

			6	9				1	2
6	9			5			4		
			7	4					
2		8						6	
1	3		9						
					3		7	6	
9						1			
	2			8					

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

1	9	4	6	5	8	2	7	3
2	5	7	4	3	9	6	1	8
3	8	6	2	1	7	5	4	9
4	1	2	5	8	3	7	9	6
7	3	9	1	2	6	8	5	4
5	6	8	7	9	4	3	2	1
9	2	5	3	6	1	4	8	7
6	4	1	8	7	5	9	3	2
8	7	3	9	4	2	1	6	5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

- Krenaria merret me "kush ka të drejtë". Mençuria merret me "çfarë është e drejtë".

- Njohurinë e pasaktë gjithmonë e ndjek një vendim i gabuar.

- Ateistët janë njerëz të veçantë. Duhet më shumë besim për t'u bërë ateist se sa fetar.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	7	2		7	3		13		2	
2	7	5			8	4	3	5	7	2	6
7		3	1	9	1	6	5	10	6	2	6
	3	5	8	2	3	5	6	1	7	5	
12	5	13	5	10	1	7		6		13	
2	7	18		5	11	2	6	5	8	2	6
8	2	6	2		2	1	8	5	11	1	
1	6	8		17	9	5	7	2		9	
3	1	5		8	2	16			2	7	1
2			3	2	6	5	9	2		1	13
6	2	7	2			3	7	10	5	6	7
	3	4	8	5	19	1	5		3	5	2

R	O	D	C	E	T	P	E	T	E	R	
O	D	L	U	A	N	E	T	K	A	K	A
M	M	E	L	P	O	M	E	N	I	I	I
A	A		P	A	L	A	M	E	D	I	D
R	L	A	R	A		S	N	O	B		
R	I	O	A	K	T	A	N	D			
Z	E	T	A	T	U	S	O	E	L	I	
S	P	I	F	F	A	R	I	S	E	J	
A	T	A	M	F	I	F	I	C	H	E	
R	I	R	U	M	J	O	S	O	N		
A	T	A	L	B	O	T	S	T	N	I	
L	I	U	A	I	E	C	O	D	A		

*Thënie të mençura*

- Pothuajse të gjithë ateistët kanë argumente për bindjet e tyre. Pothuajse asnjë fetar nuk ka argumente për bindjet e tij.
- Ai që ka një mijë miq, shumë herë përpiqet për t'i gjetur ata. Ai që ka një armik, e gjen kudo.
- Përvoja është një mësues i keq, sepse së pari ju vë në provë dhe pastaj ju jep një mësim.
- Lavdia është si rrethi në ujë.
- Vazhdimisht zgjerohet deri sa humbet.

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

HORIZONTAL  
 1. KURSIMI  
 5. YLLI I NOSTRADAMUS  
 8. TAMAM PA KUFIJ  
 11. ROSS  
 13. LASHTË  
 15. ALENCANCA  
 19. KUFIJTË  
 20. PLEPI  
 21. SHËRBIM  
 23. LAJEN  
 24. TRUAJ  
 25. PARTI  
 27. BONIFIKIM  
 28. UNIK  
 29. SHKORDRAN  
 31. DHJETORI  
 32. AKSIONI  
 33. ENTE OPERATIVE TIRANË

VERTIKAL  
 1. PËRSHTATËSHËM  
 2. FETARE  
 3. HUQ  
 4. ANALOGJI  
 6. METRI  
 7. OAZIT  
 8. ARTE

**FJALËKRYQI (2)**

HORIZONTAL  
 1. PANIKU  
 3. GIBSON  
 5. COGITO  
 9. TROFE  
 11. KATARI  
 14. MAUREEN  
 16. KUNDËRMUESË  
 17. ETAPA  
 20. OLA  
 22. THIRRJE  
 26. MINISTRI  
 27. PARIS  
 28. CIGAREJE  
 29. NGJINJA  
 32. RICCIARELLI  
 33. SEFTE

VERTIKAL  
 1. VOTË  
 2. GOMARIT  
 3. MAKINË  
 4. LEHTË  
 5. DUBLIN  
 6. HISTORISË  
 7. GAMIJË  
 8. KUFIJ  
 9. KOMITË  
 10. ISLAMABAD  
 12. TERENCE  
 13. AKTET  
 15. PERMASA  
 18. LUTJES  
 19. CASTELLITO  
 20. DALI  
 21. TANITA  
 23. TRYSNI  
 24. EUROPE  
 25. LARË  
 30. MËZA  
 31. MOREAU  
 32. THIKA  
 39. SATELITI  
 40. SENDE  
 41. MARAMENDËSE  
 42. ZDAPI  
 45. NOLTE

